



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 4 shkurt 2026
Nr. ref.: AGJ 2951/26

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KO325/25

Parashtrues

Igor Simić dhe 9 (nëntë) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Vlerësim i kushtetutshmërisë së

“Procesverbaleve nga seanca e Kuvendit të Kosovës” të 10 tetorit 2025

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Nexhmi Rexhepi, kryetar
Safet Hoxha, zëvendëskryetar
Bajram Ljatifi, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi – Peci, gjyqtare
Enver Peci, gjyqtar dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesit e kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Igor Simić, Slavko Simić, Verica Ćeranić, Zlatan Elek, Adem Hodža, Srđan Popović, Branislav Nikolić, Miljana Nikolić, Ljiljana Stefanović dhe Stefan Kovačević, deputetë të zgjedhur të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kuvendi), të cilët i përfaqëson Igor Simić, deputet i zgjedhur i Kuvendit (në tekstin mëtejshëm: parashtruesit e kërkesës).

Akti i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë kushtetutshmërinë e “*Procesverbaleve nga seanca e Kuvendit të Kosovës*”, e mbajtur më 10 tetor 2025 (në tekstin e mëtejshëm: aktet e kontestuar).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së akteve të kontestuara, për të cilat parashtruesit e kërkesës pretendojnë se janë në kundërshtim me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], paragrafin 4 të nenit 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkyetarëve] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta); nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe nenin 14 (Ndalimi i Diskriminimit) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ); pikën 1 të paragrafit 6 të nenit 12 (Zgjedhja e nënkryetarëve të Kuvendit) të Rregullores së Kuvendit; si dhe Dispozitivin e Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata) në rastet KO193/25, *Memli Krasniqi dhe 12 (dymbëdhjetë) deputetë të tjerë të Kuvendit*; dhe KO196/25, *Hykmete Bajrami dhe 10 (dhjetë) deputetë të tjerë të Kuvendit*, Aktgjykim i 7 gushtit 2025 (në tekstin e mëtejshëm: rastet KO193/25 dhe KO196/23), si dhe paragrafët 127 dhe 128 të Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese në rastin KO265/25, parashtrues “*Igor Simić dhe 9 (nëntë) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*”, Aktgjykim i 30 shtatorit 2025 (në tekstin e mëtejshëm: rasti KO265/25).
4. Përveç kësaj, parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata të vendosë masë të përkohshme, “*[...] me të cilën do të ndalohen më tej veprimet antikushtetuese të kryetarit të Kuvendit, në mënyrë që të mos zgjidhet një Qeveri antikushtetuese, sepse mosvendosja e masës së përkohshme do të shkaktonte dëm të pariparueshëm në formimin e institucioneve antikushtetuese, duke rrezikuar kështu rendin demokratik në Kosovë*”.

Baza juridike

5. Kërkesa është parashtruar bazuar në paragrafin 5 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës), 27 (Masat e përkohshme), 42 (Saktësimi i kërkesës) dhe 43 (Afati) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe rregullat 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve), 44 (Kërkesa për masë të përkohshme) dhe 72 (Kërkesa në pajtim me paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës dhe me nenet 42 dhe 43 të Ligjit) të Rregullores së punës Nr. 01/2023 së Gjykatës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 15 tetor 2025, parashtruesit e kërkesës, përmes postës elektronike, dorëzuan kërkesën në Gjykatë, të cilën kjo e fundit e regjistroi më 16 tetor 2025.
7. Më 17 tetor 2025, Kryetari i Gjykatës, përmes Vendimit [Nr. GJR. KO325/25] caktoi gjyqtarin Jeton Bytyqi gjyqtar raportues dhe përmes Vendimit [Nr. KSH. KO325/25] Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Nexhmi Rexhepi (kryesues), Safet Hoxha dhe Bajram Ljati (anëtarë).

8. Në të njëjtën ditë, Gjykata i njoftoi për regjistrimin e kërkesës: (i) parashtruesit e kërkesës, të cilëve iu kërkoj specifikimin e vendimeve të kontestuara; (ii) Presidenten e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Presidentja), e cila u njoftua edhe për mundësinë e dhënies së komenteve; (iii) Kryetarin e zgjedhur të Kuvendit, të cilit iu kërkuar që një kopje të kërkesës t'ua dorëzojë të gjithë deputetëve të Kuvendit; (iv) Avokatin e Popullit, i cili u njoftua edhe për mundësinë e dhënies së komenteve; (v) Zëvendës Sekretarin e Përgjithshëm të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Zv. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit), të cilit iu kërkuar që të dorëzojë në Gjykatë të gjitha dokumentet relevante në lidhje me objektin e çështjes së kontestuar. Afati për dorëzimin e komenteve u caktua deri më 22 tetor 2025, ndërsa afati për plotësimin e kërkesës për parashtruesit e saj dhe dorëzimin e dokumenteve relevante të Kuvendit për Zv. Sekretarin e Përgjithshëm të Kuvendit, u caktua deri më 20 tetor 2025.
9. Më 20 tetor 2025, Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit i dorëzoi Gjykatës dokumentacionin në vijim:
 - (i) Ftesa për vazhdimin e Seancës Konstituive, e cila ka filluar më 15 prill 2025, më 10 tetor 2025;
 - (ii) Propozimet me shkrim nga shumica e deputetëve nga radhët e komunitetit serb të kandidatëve për nënkryetar të Kuvendit të Kosovës: [nr. 09/060/Do-037], [nr. 09/061/Do-037/2], [nr.09/062/Do-037/3], [nr.09/063/Do-037/4], [nr.09/064/Do-037/5], [nr.09/065/Do-037/6], [nr.09/066/Do-037/7], [nr.09/067/Do-037/8] dhe [nr.09/068/Do-037/9], të 10 tetorit 2025;
 - (iii) Vendimet: [nr.09-V-044], [nr.09-V-045], [nr. 09-V-046], [nr.09-V-047], [nr.09-V-048], [nr. 09-V-049], [nr. 09-V-050], [nr.09-V-051], [nr.09-V-052], [nr.09-V-053], [nr.09-V-054], [nr.09-V-055], [nr.09-V-056], [nr.09-V-057], [nr.09-V-058], [nr.09-V-059], [nr.09-V-060], [nr.09-V-061], [nr.09-V-062], [nr. 09-V-063], [nr. 09-V-064], [nr. 09-V-065], [nr. 09-V-066], [nr. 09-V-067], [nr.09-V-068], [nr.09-V-069] dhe [nr.09-V-070], nga vazhdimi i Seancës Konstituive më 10 tetor 2025, për moszgjedhjen e nënkryetarit të Kuvendit nga radha e komunitetit serb;
 - (iv) Vendimi [nr. 09-V-071] për zgjedhjen e z. Nenad Rašić, nënkryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës nga radha e komunitetit Serb më 10 tetor 2025;
 - (v) Pjesë nga transkripti i vazhdimit të Seancës Konstituive të Kuvendit të Republikës së Kosovës (e filluar më 15 prill 2025) të 10 tetorit 2025.
10. Më 22 tetor 2025, (i) Kryetari i zgjedhur i Kuvendit, z. Dimal Basha; dhe (ii) deputetja, Saranda Bogujevci, nga Lëvizja Vetëvendosje! (në tekstin e mëtejshëm: LVV!), dorëzuan komente lidhur me kërkesën.
11. Më 27 tetor 2025, Gjykata përkritazi me komentet e pranuar njoftoi: (i) parashtruesit e kërkesës; (ii) Presidenten; (iii) Kryetarin e zgjedhur të Kuvendit, të cilit iu kërkuar që një kopje të komenteve t'ua dorëzojë të gjithë deputetëve të Kuvendit; (iv) Zëvendës Sekretarin e Përgjithshëm të Kuvendit; dhe (v) Avokatin e Popullit.
12. Më 18 dhjetor 2025, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin paraprak të propozuar nga Gjyqtari raportues dhe vendosi që shqyrtimin e kërkesës ta shtyjë për një seancë të radhës pas plotësimeve shtesë.
13. Më 15 janar 2025, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri vendosi kundër propozimit të Gjyqtarit raportues për hedhjen poshtë të kërkesës për shkak se rasti ishte jo më aktiv i diskutueshëm.

14. Në të njëjtën ditë, Gjykata, me 6 (gjashtë) vota për dhe 1 (një) kundër, vendosi që ta shpallë kërkesën të pranueshme.
15. Në po të njëjtën ditë, Gjyqtari raportues, në bazë të paragrafit (6) të rregullit 52 (Votimi) të Rregullores së punës, kërkoi nga Kryetari i Gjykatës që të caktohet një gjyqtar tjetër, nga shumica, për të përgatitur raportin paraprak që propozon pranueshmërinë e kërkesës dhe shqyrtimin në merita.
16. Në po të njëjtën ditë, në bazë të rregullit të lartcekur, Kryetari i Gjykatës e caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi, si njërin nga gjyqtarët e Kolegjit shqyrtues, për të përgatitur Projekt-Aktgjykimin.
17. Më 28 janar 2026, Gjyqtari Bajram Ljatifi prezantoi Projekt-Aktgjykimin. Në të njëjtën ditë, Gjykata, në përbërje të plotë, vendosi: (i) të deklarojë, me 6 (gjashtë) vota për dhe 1 (një) kundër, kërkesën të pranueshme; (ii) të konstatojë, me 5 (pesë) vota për dhe 2 (dy) kundër, që Vendimi [Nr. 09-V-071] i Kuvendit të Republikës së Kosovës i 10 tetorit 2025, për zgjedhjen e nënkryetarit të Kuvendit nga radhët e deputetëve të komunitetit Serb, nuk është në përputhshmëri me paragrafin 4 të nenit 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe nënkryetarëve] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nënparagrafin 1 të paragrafit 6 dhe paragrafin 7 të nenit 12 (Zgjedhja e nënkryetarëve të Kuvendit) të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës; (iii) të konstatojë, me 5 (pesë) vota për dhe 2 (dy) kundër që, bazuar në parimin e sigurisë juridike, ky Aktgjykim në rrethanat e rastit konkret nuk ka efekt prapaveprues; si dhe (iv) të refuzojë, njëzëri, kërkesën për masë të përkohshme.

Përmbledhja e fakteve

18. Gjykata fillimisht thekson që faktet që ndërlidhen me Seancën Konstitutive të Legjislaturës së IX të Kuvendit (në tekstin e mëtejme: Seanca Konstituive), e filluar më 15 prill 2025, janë të përmbledhura në Aktgjykimet e Gjykatës (i) në rastin KO124/25, me parashtrues *Time Kadrijaj dhe 10 (dhjetë) deputetë tjerë të Kuvendit*, Aktgjykim i 26 qershorit 2025; (ii) rastet KO193/25 dhe KO196/25, cituar më lart; dhe (iii) rastin KO265/25, cituar më lart.
19. Gjykata po ashtu thekson se kërkesa e tanishme e parashtruesve ndërlidhet specifikisht me procedurën e zgjedhjes së nënkryetarit nga radhët e deputetëve të komunitetit Serb në kuadër të Seancës Konstituive, cila ishte objekt shqyrtimi edhe në kërkesën paraprake të dorëzuar para Gjykatës nga parashtruesit e kërkesës, përkatësisht, kërkesën [KO265/25](#). Prandaj, në vijim, dhe për aq sa është relevante për rrethanat e kërkesës së tanishme, Gjykata do të reflektojë konstatimet e Gjykatës në Aktgjykimin në rastin KO265/25, për të vazhduar pastaj me përmbledhjen e fakteve pas hyrjes në fuqi të të njëjtit.
20. Më 30 shtator 2025, Gjykata përmes Aktgjykimit në rastin KO265/25, konstatoi që:
 - (i) Seanca Konstituive e Kuvendit, e cila ka filluar më 15 prill 2025, nuk ka përfunduar si rezultat i moszgjedhjes së nënkryetarit të Kuvendit nga radhët e deputetëve të komunitetit Serb, dhe Kuvendi nuk është konstituuar në pajtim me përcaktimet e paragrafit 1 të nenit 66 [Zgjedhja dhe Mandati] dhe paragrafët 1 dhe 4 të nenit 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkyetarëve] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

si dhe urdhëroi:

- (ii) që Seanca Konstituive e Kuvendit të përfundojë brenda afatit të përcaktuar me paragrafin 1 të nenit 66 [Zgjedhja dhe Mandati] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe sipas Aktgjykimit të Gjykatës në rastet KO193/25 dhe KO196/25, përkatësisht brenda afatit të mbetur prej 12 (dymbëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij Aktgjykimi;
 - (iii) të gjithë deputetët e zgjedhur të Kuvendit të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], nenin 7 [Vlerat], paragrafin 4 të nenit 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkryetarëve] dhe nenin 74 [Ushtrimi i Funksionit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, gjatë procedurës së zgjedhjes së nënkryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës nga radhët e deputetëve të komunitetit Serb, të ushtrojnë funksionin e tyre kushtetues në interesin më të mirë të Republikës së Kosovës dhe në pajtim me Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit;
21. Më 8 tetor 2025, Aktgjykimi i Gjykatës në rastin KO265/25 hyri në fuqi.
 22. Më 10 tetor 2025, vazhdoi Seanca Konstituive e Kuvendit. Të pranishëm në seancë ishin 105 (njëqind e pesë) deputetë. Kryetari i zgjedhur i Kuvendit, pasi sqaroi të gjeturat e Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KO265/25, vazhdoi Seancën Konstituive përkitazi me pikën e IV të rendit të ditës, përkatësisht, zgjedhjes së nënkryetarit të fundit të Kuvendit, gjegjësisht nënkryetarit nga radhët e deputetëve të komunitetit Serb. Duke iu referuar paragrafit 4 të nenit 67 të Kushtetutës dhe paragrafit 4 të nenit 12 të Rregullores së Kuvendit, Kryetari i zgjedhur i Kuvendit ftoi përfaqësuesin e shumicës së deputetëve nga radhët e deputetëve të komunitetit Serb, që të dorëzojë me shkrim dhe verbalisht propozimin për kandidatin apo kandidaten për nënkryetar/e të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Këta të fundit propozuan deputetin Slavko Simić.
 23. Në të njëjtën ditë, votimi për deputetin Slavko Simić për nënkryetar të Kuvendit dështoi 3 (tri) herë me rezultatin si vijim:
 1. Herën e parë, ku të pranishëm ishin 105 (njëqind e pesë) deputetë, 9 (nëntë) vota ishin për, 54 (pesëdhjetë e katër) kundër dhe 42 (dyzet e dy) abstenime;
 2. Herën e dytë, 9 (nëntë) vota për, 54 (pesëdhjetë e katër) kundër dhe 41 (dyzet e një) abstenime;
 3. Herën e tretë, 9 (nëntë) vota për, 53 (pesëdhjetë e tre) kundër dhe 41 (dyzet e një) abstenime.
 24. Duke qenë se votimi për deputetin Slavko Simić dështoi për 3 (tri) herë, Kryetari i zgjedhur i Kuvendit konstatoi se në përputhje me Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KO265/25, do të përdoret mekanizmi deblokues që i njëjti kandidat të mos votohet më shumë se 3 (tre) herë, dhe për pasojë, ftoi përfaqësuesin e shumicës së deputetëve nga radhët e deputetëve të komunitetit Serb që të propozojë kandidatin tjetër. Këta të fundit propozuan deputetin Zlatan Elek.
 25. Në të njëjtën ditë, votimi për deputetin Zlatan Elek për nënkryetar të Kuvendit dështoi 3 (tri) herë me rezultatin si vijim:
 1. Herën e parë, 9 (nëntë) vota ishin për, 52 (pesëdhjetë e dy) kundër dhe 42 (dyzet e dy) abstenime;

2. Herën e dytë, 9 (nëntë) vota për, 53 (pesëdhjetë e tre) kundër dhe 42 (dyzet e dy) abstenime;
 3. Herën e tretë, 9 (nëntë) vota për, 53 (pesëdhjetë e tre) kundër dhe 41 (dyzet e një) abstenime.
26. Duke qenë se votimi për deputetin Zlatan Elek dështoi për 3 (tri) herë, Kryetari i zgjedhur i Kuvendit ftoi përfaqësuesin e shumicës së deputetëve nga radhët e deputetëve të komunitetit Serb që të propozojë kandidatin tjetër. Këta të fundit propozuan deputeten Ljiljana Stefanović.
27. Në të njëjtën ditë, votimi për deputeten Ljiljana Stefanović për nënkryetare të Kuvendit dështoi 3 (tri) herë me rezultatin si vijim:
1. Herën e parë, 9 (nëntë) vota ishin për, 51 (pesëdhjetë e një) kundër dhe 41 (dyzet e një) abstenime.
 2. Herën e dytë, 9 (nëntë) vota për, 50 (pesëdhjetë) kundër dhe 38 (tridhjetë e tetë) abstenime;
 3. Herën e tretë, 9 (nëntë) vota për, 49 (dyzet e nëntë) kundër dhe 38 (tridhjetë e tetë) abstenime.
28. Duke qenë se votimi për deputeten Ljiljana Stefanović dështoi për 3 (tri) herë, Kryetari i zgjedhur i Kuvendit ftoi përfaqësuesin e shumicës së deputetëve nga radhët e deputetëve të komunitetit Serb që të propozojë kandidatin tjetër. Këta të fundit propozuan deputeten Verica Čeranić.
29. Në të njëjtën ditë, votimi për deputeten Verica Čeranić për nënkryetare të Kuvendit dështoi 3 (tri) herë me rezultatin si në vijim:
1. Herën e parë, 9 (nëntë) vota ishin për, 49 (dyzet e nëntë) kundër dhe 41 (dyzet e një) abstenime;
 2. Herën e dytë, 9 (nëntë) vota për, 51 (pesëdhjetë e një) kundër dhe 41 (dyzet e një) abstenime;
 3. Herën e tretë, 9 (nëntë) vota për, 49 (dyzet e nëntë) kundër dhe 43 (dyzet e tri) abstenime.
30. Duke qenë se votimi për deputeten Verica Čeranić dështoi për 3 (tri) herë, Kryetari i zgjedhur i Kuvendit ftoi përfaqësuesin e shumicës së deputetëve nga radhët e deputetëve të komunitetit Serb që të propozojë kandidatin tjetër. Këta të fundit propozuan deputeten Miljana Nikolić.
31. Në të njëjtën ditë, votimi për deputeten Miljana Nikolić për nënkryetare të Kuvendit dështoi 3 (tri) herë me rezultatin si në vijim:
1. Herën e parë, 9 (nëntë) vota ishin për, 49 (dyzet e nëntë) kundër dhe 42 (dyzet e dy) abstenime;
 2. Herën e dytë, 9 (nëntë) vota për, 49 (dyzet e nëntë) kundër dhe 39 (tridhjetë e nëntë) abstenime;
 3. Herën e tretë, 9 (nëntë) vota për, 49 (dyzet e nëntë) kundër dhe 39 (tridhjetë e nëntë) abstenime.

32. Duke qenë se votimi për deputeten Miljana Nikolić dështoi për 3 (tri) herë, Kryetari i zgjedhur i Kuvendit ftoi përfaqësuesin e shumicës së deputetëve nga radhët e deputetëve të komunitetit Serb që të propozojë kandidatin tjetër. Këta të fundit propozuan deputetin Branislav Nikolić.
33. Në të njëjtën ditë, votimi për deputetin Branislav Nikolić për nënkryetar të Kuvendit dështoi 3 (tri) herë me rezultatin si në vijim:
1. Herën e parë, 9 (nëntë) vota ishin për, 51 (pesëdhjetë e një) kundër dhe 41 (dyzet e një) abstenime;
 2. Herën e dytë, 9 (nëntë) vota për, 50 (pesëdhjetë) kundër dhe 40 (dyzet) abstenime;
 3. Herën e tretë, 9 (nëntë) vota për, 49 (dyzet e nëntë) kundër dhe 37 (tridhjetë e shtatë) abstenime.
34. Duke qenë se votimi për deputetin Branislav Nikolić dështoi për 3 (tri) herë, Kryetari i zgjedhur i Kuvendit ftoi përfaqësuesin e shumicës së deputetëve nga radhët e deputetëve të komunitetit Serb që të propozojë kandidatin tjetër. Këta të fundit propozuan deputetin Stefan Kovačević.
35. Në të njëjtën ditë, votimi për deputetin Stefan Kovačević për nënkryetar të Kuvendit dështoi 3 (tri) herë me rezultatin si në vijim:
1. Herën e parë, 9 (nëntë) vota ishin për, 47 (dyzet e shtatë) kundër dhe 39 (tridhjetë e nëntë) abstenime;
 2. Herën e dytë, 9 (nëntë) vota për, 47 (dyzet e shtatë) kundër dhe 37 (tridhjetë e shtatë) abstenime;
 3. Herën e tretë, 9 (nëntë) vota për, 48 (dyzet e tetë) kundër dhe 34 (tridhjetë e katër) abstenime.
36. Duke qenë se votimi për deputetin Stefan Kovačević dështoi për 3 (tri) herë, Kryetari i zgjedhur i Kuvendit ftoi përfaqësuesin e shumicës së deputetëve nga radhët e deputetëve të komunitetit Serb që të propozojë kandidatin tjetër. Këta të fundit propozuan deputetin Srđan Popović.
37. Në të njëjtën ditë, votimi për deputetin Srđan Popović për nënkryetar të Kuvendit dështoi 3 (tri) herë me rezultatin si në vijim:
1. Herën e parë, 9 (nëntë) vota ishin për, 50 (pesëdhjetë) kundër dhe 38 (tridhjetë e tetë) abstenime;
 2. Herën e dytë, 9 (nëntë) vota për, 50 (pesëdhjetë) kundër dhe 37 (tridhjetë e shtatë) abstenime;
 3. Herën e tretë, 9 (nëntë) vota për, 49 (dyzet e nëntë) kundër dhe 33 (tridhjetë e tri) abstenime.
38. Duke qenë se votimi për deputetin Srđan Popović dështoi për 3 (tri) herë, Kryetari i zgjedhur i Kuvendit ftoi përfaqësuesin e shumicës së deputetëve nga radhët e deputetëve të komunitetit Serb që të propozojë kandidatin tjetër. Këta të fundit propozuan deputetin Igor Simić.

39. Në të njëjtën ditë, votimi për deputetin Igor Simić për nënkryetar të Kuvendit dështoi 3 (tri) herë me rezultatin si në vijim:
1. Herën e parë, 9 (nëntë) vota ishin për, 49 (dyzet e nëntë) kundër dhe 36 (tridhjetë e gjashtë) abstenime;
 2. Herën e dytë, 9 (nëntë) vota për, 51 (pesëdhjetë e një) kundër dhe 37 (tridhjetë e shtatë) abstenime;
 3. Herën e tretë, 9 (nëntë) vota për, 51 (pesëdhjetë e një) kundër dhe 39 (tridhjetë e nëntë) abstenime.
40. Prandaj, Kuvendi përmes vendimeve [nr. 09-V-044], [nr. 09-V-045], [nr. 09-V-046], [nr. 09-V-047], [nr. 09-V-048], [nr. 09-V-049], [nr. 09-V-050], [nr. 09-V-051], [nr. 09-V-052], [nr. 09-V-053], [nr. 09-V-054], [nr. 09-V-055], [nr. 09-V-056], [nr. 09-V-057], [nr. 09-V-058], [nr. 09-V-059], [nr. 09-V-060], [nr. 09-V-061], [nr. 09-V-062], [nr. 09-V-063], [nr. 09-V-064], [nr. 09-V-065], [nr. 09-V-066], [nr. 09-V-067], [nr. 09-V-068], [nr. 09-V-069] dhe [nr. 09-V-070], nuk zgjodhi asnjërin nga deputetët Slavko Simić, Zlatan Elek, Ljiljana Stefanović, Verica Čeranić, Miljana Nikolić, Branislav Nikolić, Stefan Kovačević, Srđan Popović, Igor Simić nënkryetar të Kuvendit nga radhët e deputetëve të komunitetit Serb.
41. Për rrjedhojë, bazuar në transkriptin e vazhdimit të Seancës Konstituive më 10 tetor 2025, rezulton se Kryetari i zgjedhur i Kuvendit konstatoi, ndër të tjera, se: *"[...] deri më tani janë ezauruar propozimet për nëntë kandidatët deputetë të komunitetit joshumicë serb, edhe asnjëri prej tyre, pas tri tentativave, nuk i ka marrë votat e mjaftueshme për t'u zgjedhur nënkryetar."* I njëjti, ftoi 3 (tre) herë përfaqësuesin e shumicës së deputetëve nga radhët e deputetëve të komunitetit Serb që të propozojë kandidatin tjetër të mbetur nga radhët e deputetëve të komunitetit Serb.
42. Përfaqësuesi i shumicës së deputetëve nga radhët e deputetëve të komunitetit Serb, pasi që mori fjalën, theksoi se: *"Në përputhje me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese 265/25, pika 126, thuhet qartë: Kandidati për nënkryetar duhet të ketë mbështetjen e shumicës së deputetëve që mbajnë vendet e parapara për komunitetin Serb. Ne kemi listuar që të nëntë kandidatët që kanë një mbështetje të tillë, dhe unë personalisht solla nënshkrimet për të gjithë ata emra. Kështu që tani mund të propozojmë përsëri vetëm dikë nga radhët e popullit serb, i cili është pjesë e Listës serbe, sepse vetëm ata kandidatë kanë nëntë nënshkrime të mbështetjes në përputhje me nenin 67 të Kushtetutës, si dhe nenin 12 të Rregullores së punës së Kuvendit, në të cilën referohet në paragrafin 126 aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese 265/25. Çdo gjë tjetër do të ishte shkelje e Kushtetutës dhe do të na çonte më tej në krizë institucionale. Ju lutem, mos e shtyni diçka që është fakt dhe që është e qartë. Kjo pozitë i takon vetëm atij kandidati që ka nëntë nënshkrime të mbështetjes nga deputetët që mbajnë vendet e parapara për komunitetin Serb. Faleminderit!"*
43. Kryetari i zgjedhur i Kuvendit kërkoi sërish nga përfaqësuesi i shumicës së deputetëve nga radhët e deputetëve të komunitetit Serb, që të deklarojë nëse pajtohet apo refuzon ta kandidojë kandidatin e mbetur nga radhët e këtij komuniteti.
44. Përfaqësuesi i shumicës së deputetëve nga radhët e deputetëve të komunitetit Serb, pasi që mori fjalën, theksoi se: *"Është e drejta juaj të silleni në këtë sallë ashtu siç dëshironi. Ne nuk do të propozojmë asgjë që është kundër rendit juridik dhe kundër Kushtetutës. Nëse doni, siç ju dëshironi, unë përsëri e propozoj z. Slavko Simić për nënkryetar të Kuvendit. Ne nuk do të marrim pjesë në shkeljen e Kushtetutës dhe ju nuk do të na detyroni të bëjmë diçka të tillë"*.

45. Kryetari i zgjedhur i Kuvendit, duke u bazuar në paragrafin 4 të nenit 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkryetarëve] të Kushtetutës, kërkoi edhe një herë të deklarohet nëse e refuzon propozimin e kandidatit të fundit të mbetur nga komuniteti Serb dhe me këtë rast theksoi se: *“Kjo është në vullnetin tuaj të lirë. Nëse nuk i dorëzoni nënshkrimet siç parashihet edhe në Rregullore, jemi në rregull, unë do ta marr këtë si refuzim, por ju lus edhe një herë, për hir të konstruktivitetit të deklaroheni nëse doni ta propozoni edhe kandidatin, i cili nuk është propozuar asnjëherë”*.
46. Përfaqësuesi i shumicës së deputetëve nga radhët e deputetëve të komunitetit Serb, pasi që mori fjalën, theksoi se: *“Edhe herën e fundit ju pata bërë thirrje të mos e shkelni Kushtetutën dhe ju mësova si duhet të veproni. Dhe ju bëtë atë që deshët, kështu që erdhëm përsëri në të njëjtën gjë. Po lexoj aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, pika 26, paraqet [...]”*.
47. Kryetari i zgjedhur i Kuvendit, pasi ia ndërpreu fjalën deputetit Slavko Simić, konstatoi se *“[...] po refuzohet të propozohet kandidati i mbetur, i cili deputet po ashtu përfaqëson komunitetin serb, që është në harmoni të plotë me nenin 67, paragrafin 4 të Kushtetutës”*, dhe e vazhdoi Seancën Konstituive përkritazi me zgjedhjen e nënkryetarit të Kuvendit që përfaqëson komunitetin Serb, me hedhjen e shortit bazuar në paragrafin 7 të nenit 12 të Rregullores së Kuvendit. I njëjti theksoi se *“Kandidati i vetëm që nuk është propozuar deri më tani është deputeti Nenad Rashiq, i cili do t'i nënshtrohet shortit sipas nenit 12, paragrafi 7 i Rregullores së Kuvendit. Procesi i shortit administrohet nga kryetari dhe mbikëqyrët nga deputetët e komunitetit serb. Prandaj, e lus administratën të bëjë përgatitjet dhe të vazhdojmë me këtë proces, duke u bërë thirrje deputetëve të komunitetit serb që ta mbikëqyrin procedurën. Faleminderit!”*.
48. Pas përgatitjeve të nevojshme për procedurën e shortit, Kryetari i zgjedhur i Kuvendit konstatoi se: *“[...] meqenëse e kemi vetëm një kandidat dhe nuk ka nevojë që të hedhet short, meqenëse është një i vetëm. Prandaj, i lus deputetët që të zënë vendet, për shkak se do të procedojmë me votim”*.
49. Në të njëjtën ditë, Kryetari i zgjedhur i Kuvendit ftoi deputetët e zgjedhur të Kuvendit, që me ngritje dore të votojnë për kandidatin Nenad Rašić për nënkryetar të Kuvendit nga radhët e deputetëve të komunitetit Serb, e cila kandidaturë mori 71 (shtatëdhjetë e një) vota për, 9 (nëntë) kundër dhe 24 (njëzet e katër) abstenime.
50. Prandaj, Kuvendi përmes Vendimit [nr. 09-V-71] zgjodhi deputetin Nenad Rašić nënkryetar të Kuvendit nga radhët e deputetëve të komunitetit Serb.
51. Kryetari i Kuvendit pasi dha njoftimin për formimin e grupeve parlamentare, theksoi se: *“Me zgjedhjen e nënkryetarit të pestë nga komuniteti serb, konstatoj se Kuvendi është i konstituuar dhe me këtë i mbyll punimet e seancës konstituive të Legjislaturës IX të Kuvendit të Republikës së Kosovës”*.
52. Më 11 tetor 2025, Presidentja përmes Dekretit [nr. 170/2025] ia propozoi Kuvendit, z. Albin Kurti, kandidat për kryeministër për ta formuar Qeverinë.
53. Më 26 tetor 2025, u zhvillua seanca e jashtëzakonshme për zgjedhjen e Qeverisë, me ç' rast i mandatuari për formimin e Qeverisë i prezantoi Kuvendit propozimin për përbërjen e saj.

Megjithatë, Kuvendi përmes Vendimit [nr. 09-V-072] nuk zgjodhi Qeverinë e Republikës së Kosovës, pasi propozimi mori votat si në vijim: 56 (pesëdhjetë e gjashtë) vota për, 52 (pesëdhjetë e dy) kundër dhe 4 (katër) abstenime.

54. Më 4 nëntor 2025, Presidentja përmes Dekretit [nr. 184/2025] ia propozoi Kuvendit, z. Glauk Konjufca, kandidat për kryeministër për ta formuar Qeverinë.
55. Më 19 nëntor 2025, në orën 14:00 filloi seanca e jashtëzakonshme për zgjedhjen e Qeverisë, me ç' rast i mandatuari për formimin e Qeverisë i prezantoi Kuvendit propozimin për përbërjen e saj. Megjithatë, Kuvendi përmes Vendimit [nr. 09-V-073] nuk zgjodhi Qeverinë e Republikës së Kosovës, pasi propozimi mori votat si në vijim: 56 (pesëdhjetë e gjashtë) vota për, 53 (pesëdhjetë e tri) kundër dhe 4 (katër) abstenime.
56. Më 20 nëntor 2025, Presidentja përmes Dekretit [nr. 209/2025], duke u bazuar, ndër të tjera, në paragrafin 4 të nenit 95 [Zgjedhja e Qeverisë] të Kushtetutës, shpërndau Legjislaturën e Nëntë (IX) të Kuvendit.
57. Në të njëjtën ditë, Presidentja përmes Dekretit [nr. 210/2025], caktoi 28 dhjetorin 2025 për mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme për Kuvend.

Pretendimet e parashtruesve të kërkesës

58. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë kushtetutshmërinë e “*Procesverbaleve nga seancat e Kuvendit të Kosovës*”, me pretendimin se Kryetari i zgjedhur i Kuvendit, kishte përzgjedhur kandidatët për nënkryetar të Kuvendit nga radhët e komunitetit serb “*pa propozim dhe pa mbështetjen*” e deputetëve të komunitetit Serb, dhe në këtë mënyrë ka shkelur paragrafin 4 të nenit 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkyetarëve] të Kushtetutës dhe pikën 1 të paragrafit 6 të nenit 12 (Zgjedhja e nënkryetarëve të Kuvendit) të Rregullores së Kuvendit, si dhe ka vepruar në kundërshtim me dispozitivin e Aktgjyimit të Gjykatës Kushtetuese në rastin KO265/25, dhe në kundërshtim me sigurinë juridike, duke shkelur në këtë mënyrë edhe nenin 31 [E Drejta në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Kosovës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së dhe nenin 24 [Barazia Para Ligjit] të Kushtetutës së Kosovës në lidhje me nenin 14 (Ndalimi i Diskriminimit) të KEDNJ-së.
59. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Kryetari i zgjedhur i Kuvendit “*këmbënguli*” që deputetët nga radhët e komunitetit Serb të propozojnë deputetin Nenad Rašić për nënkryetar të Kuvendit, duke shtuar se të njëjtit kishin theksuar se, deputeti Nenad Rašić “*nuk ka mbështetjen e shumicës së deputetëve që zënë vendet e rezervuara për komunitetin serb, gjë që është një kusht i domosdoshëm për të kandiduar për pozitën e nënkryetarit të Kuvendit, të rezervuar për komunitetin serb në pajtim me nenin 67, paragrafi 4 të Kushtetutës dhe nenin 12, paragrafi 6 të Rregullores së punës së Kuvendit dhe paragrafët 127 dhe 128 të aktgjyimit të Gjykatës Kushtetuese KO265/25*”.
60. Në këtë drejtim, parashtruesit e kërkesës theksojnë se si pasojë e dështimit të zgjedhjes së nënkryetarëve sipas propozimeve të paraqitura me shkrim nga radhët e deputetëve të komunitetit Serb, Kryetari i zgjedhur i Kuvendit, zbatoi paragrafin 7 të nenit 12 të Rregullores së Kuvendit, “*sikur të mos kishte kandidatë të propozuar, edhe pse Igor Simić për çdo propozim kishte paraqitur me shkrim 9 nënshkrime mbështetjeje për kandidatin për nënkryetar, vazhdoi me përzgjedhjen e kandidatëve për nënkryetar të Kuvendit të Kosovës nga radhët serbe pa propozim dhe pa mbështetjen e shumicës së deputetëve që*

zënë vendet e rezervuara për komunitetin serb, duke i dhënë vetes të drejtën të propozojë kandidatë, me arsyetimin se shorti nuk është i mundur sepse sipas mendimit të tij ka mbetur vetëm edhe një kandidat”.

61. Sipas parashtresve të kërkesës, Kryetari i zgjedhur i Kuvendit kërkoi nga deputetët e Kuvendit që të votonin lidhur me propozimin për zgjedhjen e Nenad Rašić për nënkryetar nga radhët e deputetëve të komunitetit Serb, propozim ky që mori numrin e nevojshëm të votave të deputetëve, respektivisht 71 (shtatëdhjetë e një) vota dhe më pas *“Kryetari e mbylli seancën konstituive duke konsideruar se është zgjedhur kryesia e Kuvendit të Kosovës”*. Në ndërlidhje me këtë, parashtresit e kërkesës pretendojnë se propozimi për zgjedhjen e deputetit Nenad Rašić, nënkryetar të Kuvendit nga radhët e deputetëve të komunitetit Serb nuk u dorëzua me shkrim, por erdhi nga Kryetari i zgjedhur i Kuvendit dhe jo nga deputetët e komunitetit Serb, duke shtuar se *“madje as vetë Nenad Rašić, i cili nuk e propozoi veten për nënkryetar”*.
62. Parashtresit e kërkesës në këtë mënyrë pretendojnë se: *“[...] është shkelur “themeli i një demokracie efektive dhe kuptimplotë në konstituimin e Kuvendit”, siç u theksua nga Gjykata në aktgjykimin KO 265/25”*.
63. Më tej, parashtresit e kërkesës para Gjykatës theksojnë se: *“[...] kërkesa jonë i referohet të drejtës që u takon përfaqësuesve të tri partive që morën më shumë vota në zgjedhjet parlamentare”, duke shtuar që edhe nënkryetari i Kuvendit nga radhët e komunitetit Serb “sipas parimit të analogjisë”, dhe sipas Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KO265/25, duhet të ketë mbështetjen e shumicës së deputetëve të komunitetit serb, që sipas tyre përbën kushtin e parë drejt zgjedhjes së nënkryetarit nga radhët e komunitetit Serb*.
64. Tutje, parashtresit e kërkesës po ashtu në kërkesën e tyre theksojnë se: *“Kjo nuk është procedurë e zhbllokimit të Kuvendit, por imponim i vullnetit të shumicës mbi pakicën, me çka shkelet Kushtetuta dhe fryma e saj, me të cilën garantohet dhe mbrohet karakteri multietnik i Kosovës. Gjatë kësaj seance konstituive, në 58 seanca të mbajtura nuk është zgjedhur kryetari i Kuvendit, por e drejta për të propozuar kryetarin nuk i është hequr partisë me numrin më të madh të votave.”* duke vazhduar se *“Pranimi i imponimit të nënkryetarit të Kuvendit të Kosovës nga radhët e popullit serb nga ana e shumicës së deputetëve të komuniteteve të tjera do të anulonte përfaqësimin autentik të komunitetit serb në Kuvend dhe parimi i marrjes së përbashkët të vendimeve do të shndërrohej në një mekanizëm simbolik”*.
65. Parashtresit e kërkesës po ashtu kërkojnë nga Gjykata që të vendosë masë të përkohshme sepse sipas tyre: *“[...] do të ndalohen më tej veprimet antikushtetuese të kryetarit të Kuvendit, në mënyrë që të mos zgjidhet një Qeveri antikushtetuese, sepse mosvendosja e masës së përkohshme do të shkaktonte dëm të pariparueshëm në formimin e institucioneve antikushtetuese, duke rrezikuar kështu rendin demokratik në Kosovë”*.
66. Në fund, parashtresit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata që: (i) të aprovojë kërkesën si të bazuar; (ii) të konstatojë se *“kryetari i Kuvendit ka shkelur nenin 67, paragrafi 4, të Kushtetutës, nenin 12, paragrafi 6, të Rregullores së punës së Kuvendit, si dhe ka vepruar në kundërshtim me dispozitivët e aktgjykimeve të Gjykatës Kushtetuese KO193/25, KO 196/25 dhe KO 265/25, veçanërisht me paragrafët 127 dhe 128 të aktgjykimit”*; (iii) të konstatojë *“se kryetari i Kuvendit ka tejkaluar kompetencat e tij kur ia ka dhënë vetes të drejtën të propozojë kandidatin për nënkryetar të Kuvendit nga radhët e popullit serb,*

pa mbështetjen e shumicës së deputetëve që zënë vendet e rezervuara për komunitetin serb dhe pa propozim me shkrim, siç është paraparë me nenin 67, paragrafi 4 të Kushtetutës, nenin 12, paragrafi 6 të Rregullores së punës së Kuvendit dhe paragrafët 127 dhe 128 të aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese KO265/25”; (iv) të konstatojë “se zgjedhja e nënkryetarit të Kuvendit të Kosovës që i takon komunitetit serb është antikushtetuese dhe e paligjshme [...]”; (v) ta urdhërojë “kryetarin e Kuvendit që ta kthejë gjendjen e mëparshme, me ç’ rast do të anulohen veprimet e mëparshme antikushtetuese të kryetarit të Kuvendit”; (iv) të urdhërojë “përsëritjen e votimit për zgjedhjen e nënkryetarit të Kuvendit të Kosovës nga radhët e popullit serb”; si dhe (vii) të vendos masën e përkohshme.

Komentet e Kryetarit të zgjedhur të Kuvendit, z. Dimal Basha

67. Më 22 tetor 2025, Kryetari i zgjedhur i Kuvendit, z. Dimal Basha, dorëzoi në Gjykatë komentet lidhur me kërkesën.
68. Kryetari i zgjedhur i Kuvendit fillimisht thekson se pas publikimit të Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese në rastin KO265/25, kishte caktuar vazhdimin e Seancës Konstituive më 10 tetor 2025, në orën 10:00, me qëllim kompletimin e përbërjes së Kryesisë së Kuvendit me zgjedhjen e nënkryetarit nga radhët e deputetëve të komunitetit Serb. I njëjti elaboroi rrjedhën e vazhdimin të Seancës Konstituive më 10 tetor 2025, me ç’ rast nënvizon faktin se e ftoi përfaqësuesin nga radhët e deputetëve të komunitetit Serb që të propozojë kandidatin për nënkryetarin nga ky komunitet, dhe më pas përmend dështimin e votimit të secilit kandidat të propozuar nga ana e këtij përfaqësuesi, gjegjësisht, 9 (nëntë) kandidatëve, të cilët nuk morën votat e nevojshme për t’u zgjedhur nënkryetar të Kuvendit nga radhët e deputetëve të komunitetit Serb.
69. Për më tepër, Kryetari i zgjedhur i Kuvendit thekson se, bazuar në parimet e trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit, kërkoi në mënyrë specifike 3 (tri) herë nga përfaqësuesi nga radhët e deputetëve të komunitetit Serb që ta propozojnë deputetin e mbetur (deputetin Nenad Rašić) nga ky komunitet që ende nuk ishte propozuar, por që i njëjti kishte refuzuar dhe këmbëngulur që të përsëritej votimi për kandidatët e njëjtë. Si pasojë e këtij refuzimi, i njëjti thekson se ishte i detyruar të vazhdojë me aktivizimin e procedurës së shortit të paraparë në paragrafin 7 të nenit 12 të Rregullores së Kuvendit.
70. Përkitazi me pretendimet e parashtresve të kërkesës se ai, si Kryetar i Kuvendit kishte vepruar “arbitrarisht” në propozimin e deputetit Nenad Rašić, Kryetari i zgjedhur i Kuvendit konsideron se kishte respektuar procedurën kushtetuese dhe atë përcaktuar në Rregulloren e Kuvendit dhe Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese në rastin KO265/25 në lidhje me hapat proceduralë për zgjedhjen e nënkryetarit të Kuvendit nga radhët e deputetëve të komunitetit Serb. Kjo sepse vetëm pasi 9 (nëntë) kandidatët e propozuar nga përfaqësuesi i këtij komuniteti dhe refuzimi i të njëjtit për të propozuar deputetin e mbetur, Nenad Rašić, atëherë kishte vazhduar me procedurën e shortit. I njëjti thekson se rifillimi i votimit për kandidatët e njëjtë sipas kërkesës së përfaqësuesit nga radhët e deputetëve të komunitetit serb do të mund të bëhej vetëm në rast se as deputeti i 10-të (dhjetë), nuk do të merrte votat e nevojshme për t’u zgjedhur “Nënkryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës, në frymë të plotë me paragrafin 153 të Aktgjykimit 265/25 të Gjykatës Kushtetuese të datës 8 tetor 2025”. Për më tepër, i njëjti thekson në komentet e tij se “Meqenëse kishte vetëm një kandidat të mbetur, tërheqja e shortit ishte e panevojshme dhe rrjedhimisht u procedua drejtpërdrejt me votimin e kandidatit, që ishte deputeti

Nenad Rashiq, i cili përfaqëson komunitetin joshumicë serb në Kuvendin e Republikës së Kosovës, sipas nenit 67, paragrafi 4 të Kushtetutës”.

71. Në lidhje me pretendimet e parashtruesve të kërkesës për analogji në mes të zgjedhjes së nënkryetarëve nga radhët e grupeve më të mëdha parlamentare dhe mes nënkryetarëve nga radhët e deputetëve që nuk janë shumicë, Kryetari i zgjedhur i Kuvendit nënvizon se kjo analogji nuk qëndron, ndër të tjera, për shkak se: (i) paragrafi 3 i nenit 67 të Kushtetutës specifikisht ia jep të drejtën ekskluzive 3 (tre) grupeve më të mëdha parlamentare për propozim, përderisa paragrafi 4 i nenit 67 të Kushtetutës qëndron i heshtur se kush ka të drejtën e propozimit; (ii) paragrafi 4 i nenit 67 të Kushtetutës ekskluzivisht i garanton komunitetit Serb pozitën e nënkryetarit dhe këtë nuk e redukton në asnjë grup parlamentar apo subjekt të caktuar politik; dhe (iii) paragrafi 6 i nenit 12 të Rregullores së Kuvendit i garanton shumicës së deputetëve nga radhët e komuniteteve që nuk janë shumicë të drejtën për propozim të nënkryetarit dhe se në dështim të kësaj dispozite, aktivizohet klauzola e shortit sipas paragrafit 7 të nenit 12 të Rregullores së Kuvendit, e cila nuk vlen te procedura e zgjedhjes së nënkryetarëve nga 3 (tre) grupet më të mëdha parlamentare.
72. Lidhur me pretendimin e parashtruesve të kërkesës që propozimi i deputetit Nenad Rašić për nënkryetar të Kuvendit nuk ka ardhur nga vullneti i shumicës së deputetëve nga radhët e komunitetit Serb, Kryetari i zgjedhur i Kuvendit konsideron se në asnjë rast të vetëm përfaqësuesit të këtij komuniteti nuk i është mohuar e drejta për të propozuar nënkryetarin e Kuvendit. Për më tepër, në kontekst të vullnetit të lirë të deputetëve për të votuar një kandidat “për”, “kundër”, apo të “abstenojnë”, i njëjti thekson se: “Kryetari i Kuvendit dhe askush tjetër nuk mund të ketë përgjegjësi pse asnjëri nga 9 deputetët e propozuar nuk e ka arritur shumicën e nevojshme për t’u zgjedhur në pozitën e Nënkyetarit”.
73. Kryetari i zgjedhur i Kuvendit gjithashtu thekson se: “[...] duke ftuar propozuesin e komunitetit serb (i cili refuzoi plot 3 herë) ta propozojnë deputetin e vetëm të papropozuar, është respektuar neni 67, paragrafi 4, pra është siguruar Barazia para Ligjit dhe mosdiskriminimi sipas neneve 7 dhe 24 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, kurse mbi bazën e vullnetit të lirë të deputetëve, votimi për deputetin Nenad Rashiq ka rezultuar i suksesshëm me plotësimin e kushtit për marrje të votave të shumicës së të gjithë deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, siç edhe parashihet me Rregullore të Kuvendit dhe me Kushtetutë”.
74. Në fund, Kryetari i zgjedhur i Kuvendit nënvizon se “[...] jashtëzakonisht relevante të bëhet i ditur dhe të merret parasysh fakti se në votimin e deputetit Nenad Rashiq për pozitën e Nënkyetarit të Kuvendit, kanë marrë pjesë të gjithë deputetët e subjektit politik Lista Serbe duke votuar “kundër” me ç’ rast gjithsej ishin 9 vota nga ana e tyre, që dëshmon legjitimin dhe pajtimin me këtë proces të votimit të deputetit nga radhët e komunitetit joshumicë serb nga ana e tyre”.

Komentet e LVV!

75. Më 22 tetor 2025, deputetët e LVV!, të përfaqësuar nga deputetja Saranda Bogujevci, dorëzuan në Gjykatë komentet lidhur me kërkesën.
76. Fillimisht, deputetët e LVV! konsiderojnë se parashtruesit e kërkesës nuk kanë ofruar argumente, të cilat do të mund të mbështesnin pranueshmërinë e saj, për shkak se mungon akti i kontestuar. Përkitazi me mungesën e aktit të kontestuar theksojnë se parashtruesit e

kërkesës “[...] jo vetëm se nuk specifikojnë ndonjë akt të miratuar nga Kuvendi, por nuk kontestojnë ndonjë akt të miratuar, qoftë për procedurën e miratimit apo për përmbajtjen e aktit”. Parashtruesit e kërkesës më tej në ndërlidhje me pranueshmërinë e kërkesës shtojnë se “[...] në rastin konkret megjithëse kemi akt të miratuar nga Kuvendi, parashtruesit nuk e kontestojnë aktin e miratuar nga Kuvendi por kontestojnë sjelljet dhe veprimet e Kryetarit të Kuvendit”.

77. Në këtë drejtim, deputetët e LVV! tutje theksojnë se: “Parashtruesit nuk kontestojnë vendimin e Kuvendit me të cilin është zgjedhur nënkryetari i pestë i Kuvendit të Kosovës nga komuniteti joshumicë serb, nga mesi i deputetëve që mbajnë mandatin nga vendet e rezervuara për komunitetin joshumicë serb, por kontestojnë veprimet e Kryetarit të Kuvendit që kanë çuar në përfundimin e plotë të konstituimit të Kuvendit të Republikës si një synim i lartë me interes publik dhe veprim i parë pas zgjedhjeve të mbajtura më 09.02.2025, në përputhje me Kushtetutën dhe në bazë të aktgjykimeve të Gjykatës Kushtetuese.” Në ndërlidhje me këtë, të njëjtit pretendojnë se pavarësisht se ekziston akti i miratuar i Kuvendit, ky akt nuk kontestohet nga parashtruesit e kërkesës as në përmbajtje dhe as si procedurë dhe se Gjykata duhet të mbetet rigorozë në kriteret e saj për vlerësimin e pranueshmërisë së kërkesave. Për pasojë, kërkojnë nga Gjykata që kërkesën KO325/25, ta hedhin poshtë si të papranueshme.
78. Në lidhje me meritat e kërkesës, deputetët e LVV! konsiderojnë se kërkesa është krejtësisht e pabazuar dhe se “Pretendimet e parashtruesve nuk gjejnë mbështetje as në tekstin e Kushtetutës, as në parimet themelore të rendit kushtetues dhe as në jurisprudencën ekzistuese të Gjykatës Kushtetuese”.
79. Në lidhje me pretendimin e parashtruesve të kërkesës se 2 (dy) nënkryetarët e Kuvendit të zgjedhur sipas paragrafit 4 të nenit 67 të Kushtetutës duhet të replikojnë në analogji zgjedhjen e 3 (tre) nënkryetarëve të zgjedhur sipas paragrafit 3 të nenit 67 të Kushtetutës, deputetët e LVV! theksojnë se kjo analogji është krejtësisht e paqëndrueshme, duke cituar paragrafin 109 të Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KO265/25. Në këtë kontekst, të njëjtit nënvizojnë se paragrafi 4 i nenit 67 të Kushtetutës nuk parashikon se: “(i) kandidati duhet të vijë nga një grup i caktuar parlamentar ose subjekt politik; (ii) kriter vendimtar nuk është numri i votave të një partie apo kandidati, përtej kategorisë së vendeve të rezervuara; apo (iii) deputetët e komuniteteve përkatëse duhet të zhvillojnë votim paraprak ose ndonjë procedurë të veçantë brenda grupit.”
80. Për më tepër, lidhur me pretendimin e lartcekur, deputetët e LVV! shtojnë se: “[...] është i dukshëm vullneti i kushtetutbërësit, kur zhvendoset nga kriteri i votave te kriteri i përfaqësimit të komuniteteve. Përderisa në paragrafin 3 të nenit 67, përcaktohet se: “Tre (3) nënkryetarët të propozuar nga tri grupet më të mëdha parlamentare, zgjidhen me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit.”, kemi krejt tjetër kriter në paragrafin 4 të të njëjtit nen, duke kapërcyer nga kushti i fuqisë politike te ruajtja e strukturës së Kryesisë së Kuvendit në kuptimin e përfaqësimit të komuniteteve. Është mëse e qartë, po aq sa edhe funksionale, se kushtetutbërësi ka pasur parasysh përfaqësimin horizontal, e jo renditjen vertikale sipas numrit të votave. Po të ishte qëllimi i ndjekjes së parimit të numrit të votave, siç ka bërë me tre nënkryetarët tjerë të tre grupeve më të mëdha, do ta kishte paraparë edhe për dy nënkryetarët nga komunitetet joshumicë. Padyshim kjo do të ishte e lehtë të bëhej po të ishte ky synimi, duke përcaktuar se dy nënkryetarët nga komunitetet joshumicë vijnë nga radhët e dy grupeve parlamentare më të mëdha që mbajnë vende të rezervuara apo të garantuara. Por ky nuk ka qenë qëllimi. Për rrjedhojë nuk vlen parimi i përfaqësimit partiak kur bëhet fjalë për

nënkryetarët e komuniteteve, por parimi i përfaqësimit të komunitetit apo komuniteteve [...]”.

81. Në kontekst të respektimit të aktgjykimeve të Gjykatës Kushtetuese dhe parimit të funksionalitetit institucional, deputetët e LVV! theksojnë se: *“Kuvendi gjendej përballë një bllokimi faktik që rrezikonte funksionimin e institucionit dhe konstituimin e plotë të tij. Sipas jurisprudencës krahasimtare, ushtrimi i një të drejte kushtetuese bëhet abuziv nëse qëllimi i saj nuk është realizimi i funksionit të garantuar nga Kushtetuta, por paralizimi i funksionimit të institucioneve shtetërore. Prandaj, detyrimi i Kryetarit të Kuvendit për të siguruar efektivitetin e prerogativës dhe/ose urdhrin kushtetues prevalon mbi çdo përpjekje për ta kthyer të drejtën e përfaqësimit në mjet bllokues”.*
82. Për më tepër, deputetët e LVV! konsiderojnë se zgjedhja e *“deputetit të fundit që mban vendin e rezervuar për komunitetin serb”* me gjithsej 71 (shtatëdhjetë e një) vota, dhe se rrjedhimisht, sipas tyre, *“[...] nuk përbën shkelje të të drejtës së komunitetit serb, por përkundrazi, është shprehje e zbatimit të mirëfilltë të parimit të shtetit funksional dhe të garancisë së efektivitetit kushtetues. Prandaj, pretendimi i parashtruesve se Kryetari ka “injoruar” propozimet me shkrim dhe me gojë të nëntë deputetëve të komunitetit serb është pa bazë faktike dhe juridike, sepse transkripti zyrtar i seancës së datës 10 tetor 2025, dëshmon qartë se Kryetari, në mënyrë të përsëritur dhe të dokumentuar, ka kërkuar nga përfaqësuesit e Listës Serbe që të bëjnë propozimin e tyre. Në të gjitha raundet e votimit për 9 (nëntë) kandidatët në fjalë, Kuvendi ka respektuar parimet e barazisë procedurale, ndërsa dështimi për zgjedhje ka qenë pasojë e mungesës së konsensusit politik, jo e ndonjë devijimi kushtetues”.*
83. Deputetët e LVV! po ashtu nënvizojnë se Kryetari i zgjedhur i Kuvendit kishte respektuar aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese kur kishte vazhduar me procedurën e shortit, për të cilën procedurë theksojnë se: *“[...] shorti përbën një mjet të pranueshëm kushtetues për të kapërcyer situatat e bllokimit (specifikisht e parashih si institut juridik deblllokues), për aq kohë sa përdoret si mjet proporcional për të ruajtur funksionalitetin institucional dhe përfaqësimin kushtetues të komuniteteve, ashtu siç edhe ligjbërësi e ka paraparë këtë mjet të vlefshëm juridik dhe e ka parashikuar me Rregulloren e Punës së Kuvendit.”*
84. Në anën tjetër, deputetët e LVV! sqarojnë se: *“Vendimet e mëhershme të Gjykatës (p.sh. KO119/14: “VLAN”) lidhen me zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit, por jo të nënkryetarëve. Ato nuk janë dhe nuk mund të paraqesin analogji të detyrueshme. Rrjedhimisht, shorti është një mekanizëm neutral, i përdorur në praktika parlamentare evropiane (p.sh. në Kuvendin e Sllovenisë dhe atë të Kroacisë) për të evituar vakumin institucional. Neni 67, paragrafi 4 i Kushtetutës së Kosovës, kërkon vetëm rezultatin (zgjedhjen e dy nënkryetarëve) dhe jo metodën e saktë të votimit. Kuvendi ka diskrecion të arsyeshëm për procedurën në fjalë”. Në këtë kontekst, të njëjtit theksojnë se: “Garancitë kushtetuese nuk mund të interpretohen në mënyrën që i paralizojnë institucionet shtetërore ose pamundësojnë funksionimin normal të rendit demokratik. Parimi i funksionalitetit institucional është pjesë e vetë “kushtetutës materiale” të demokracisë. Për më tepër, Gjykata Kushtetuese Federale e Gjermanisë (BVerfGE 123, 267 “–Lissabon Urteil”), thotë shprehimisht se, garancitë kushtetuese nuk mund të interpretohen në mënyrë që paralizojnë institucionet”.*
85. Deputetët e LVV! gjithashtu theksojnë se: *“Kushtetuta nuk e njeh monopolin e një partie politike mbi vendin e rezervuar të komunitetit, por garanton që komunitetet të kenë përfaqësim efektiv. Në përputhje me frymën e jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për*

të Drejtat e Njeriut mbi pluralizmin politik (shih Yumak dhe Sadak kundër Turqisë, 2008), “përfaqësimi nuk mund të reduktohet tek vetëm një subjekt politik.” Kandidatura duhet të vijë nga radhët e deputetëve që mbajnë mandatin e komunitetit, por nuk mund të bllokohet nga një parti e vetme duke refuzuar çdo alternativë tjetër. Prandaj, kandidatura jo monopoliste e një deputeti të zgjedhur dhe të betuar të Kuvendit të Kosovës, është plotësisht kushtetuese, pasi që ai/ajo e përfaqëson komunitetin e tij. Komisioni i Venecias, në Opinionin CDL-AD (2010)014, ka theksuar se përfaqësimi i pakicave duhet të jetë çdoherë real dhe funksional.” Për më tepër, të njëjtit nënvizojnë se: “Edhe sipas standardeve ndërkombëtare, vendet e rezervuara nuk janë të konceptuara si mekanizma të përhershëm, por si instrumente kalimtare që synojnë afirmimin e komuniteteve joshumicë dhe integrimin e tyre të plotë institucional. Komisioni i Venecias, në Opinionin CDL-PI (2018)02, ka theksuar se “ndërsa vendet e rezervuara mund të jenë një mekanizëm afatshkurtër për të siguruar përfaqësimin e pakicave në një periudhë tranzicioni, në planin afatgjatë interesi i pakicave dhe i vetë vendit mund të shërbehet më mirë nga përfaqësimi përmes sistemit zgjedhor të zakonshëm.” Për më tepër, kombinimi i vendeve të rezervuara me të drejtën e vetos shihet me shqetësim të veçantë, pasi rrezikon të kufizojë procesin e vendimmarrjes demokratike dhe të minojë funksionalitetin e institucioneve kushtetuese”.

86. Lidhur me pretendimin e parashtruesve të kërkesës për analogjinë e grupit më të madh parlamentar dhe të drejtës për të propozuar kandidatin për “Kryetar të Kuvendit” kundrejt të drejtës që komuniteti Serb në Kuvend duhet ta ketë, deputetët e LVV! theksojnë se: “Kushtetuta e Kosovës nuk e parasheh këtë të drejtë për nënkryetarin nga komuniteti jo shumicë serb. [...] vendet e rezervuara në Kuvend nuk kanë të bëjnë me përfaqësimin dhe garën siç e ka pjesa tjetër e deputetëve dhe subjekteve politike që garojnë për 100 vende e tjera në Kuvend me pragun 5%. Kushtetuta u ka dhënë vende të rezervuara komuniteteve duke mos i lënë ato në kushtin e garës elektorale, pra pa prag zgjedhor. Po ashtu, përveç lirit nga domosdoshmëria për kalimin e pragut, të paktën disa subjekte dhe kandidatë të komuniteteve me vende të rezervuara, edhe në mungesë të pragut, nuk do të kishin vota të mjaftueshme për të fituar ulëse në Kuvend, po të ishin në konkurrencë të drejtpërdrejtë dhe demokratik me subjekte dhe kandidatë të tjerë të komunitetit shumicë”.
87. Në fund, deputetët e LVV! kërkojnë nga Gjykata që: (i) ta hedhë poshtë si të papranueshme kërkesën KO325/25; (ii) ta refuzojë kërkesën për masë të përkohshme; dhe (iii) të konstatojë se: “Kuvendi i Republikës së Kosovës ka vepruar në përputhje të plotë me Kushtetutën dhe me aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese (KO 265/25, KO 193/25 dhe KO 196/25), duke garantuar përfaqësimin e komuniteteve joshumicë dhe funksionalitetin e institucioneve shtetërore.”

Dispozitat relevante kushtetuese

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 3

[Barazia para Ligjit]

“1. Republika e Kosovës është shoqëri shumetnike, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet tjera e cila qeveriset në mënyrë demokratike, me respektim të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të veta legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore.
2. Ushtrimi i autoritetit publik në Republikën e Kosovës bazohet në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive

themelore të njeriut, të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe në pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre.”

Neni 4 **[Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit]**

- “1. Kosova është Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre, sikurse është përcaktuar me këtë Kushtetutë.*
- 2. Kuvendi i Republikës së Kosovës ushtron pushtetin legjislativ.*
- 3. Presidenti i Republikës së Kosovës përfaqëson unitetin e popullit. Presidenti i Republikës së Kosovës është përfaqësues legjitim i vendit brenda dhe jashtë dhe garantues i funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, në pajtim me këtë Kushtetutë.*
- 4. Qeveria e Republikës së Kosovës është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve e politikave shtetërore dhe i nënshtrohet kontrollit parlamentar.*
- 5. Pushteti gjyqësor është unik, i pavarur dhe ushtrohet nga gjykatat.*
- 6. Gjykata Kushtetuese është organ i pavarur i mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës.*
- 7. Republika e Kosovës ka institucionet e veta për mbrojtjen e rendit kushtetues dhe të integritetit territorial, rendit dhe qetësisë publike, të cilat funksionojnë nën autoritetin kushtetues të institucioneve demokratike të Republikës së Kosovës.”*

Neni 7 **[Vlerat]**

- “1. Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, pages, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes e mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut.*
- 2. Republika e Kosovës siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat të tjera të jetës shoqërore.”*

Neni 24 **[Barazia para Ligjit]**

- “1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.*
- 2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.*
- 3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.”*

Neni 31
[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

“1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike. [...]”

Neni 58
[Përgjegjësitë e Shtetit]

“[...]”
7. Republika e Kosovës siguron, në baza jodiskriminuese, që të gjitha komunitetet dhe pjesëtarët e tyre të mund të ushtrojnë të drejtat e tyre, të specifikuara me këtë Kushtetutë.”

Neni 63
[Parimet e Përgjithshme]

“Kuvendi është institucion ligjvënës i Republikës së Kosovës i zgjedhur drejtpërdrejt nga populli.”

Neni 64
[Struktura e Kuvendit]

“1. Kuvendi ka njëqind e njëzet (120) deputetë të zgjedhur me votim të fshehtë bazuar në listat e hapura. Vendet në Kuvend ndahen midis të gjitha partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, në përpjesëtim me numrin e votave të vlefshme, të fituara prej tyre, në zgjedhjet për Kuvendin.
2. Në kuadër të kësaj ndarjeje, njëzet (20) prej njëqind e njëzet (120) vendeve janë të garantuara për përfaqësimin e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovës, si vijon: (1) partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetin Serb, do të kenë numrin e vendeve në Kuvend të fituar në zgjedhjet e hapura, me minimumin dhjetë (10) vende të garantuara, në rast se numri i vendeve të fituara është më i vogël se dhjetë (10);
(2) partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetet e tjera, në Kuvend do të kenë numrin e vendeve të fituara në zgjedhjet e hapura me minimumin e vendeve të garantuara si në vijim: komuniteti Rom një (1) vend; komuniteti Ashkali një (1) vend; komuniteti Egjiptian një (1) vend; dhe një (1) vend shtesë do t'i jepet komunitetit Rom, Ashkali, ose Egjiptian, që ka numrin më të madh të votave të përgjithshme; komuniteti Boshnjak tri (3) vende, komuniteti Turk dy (2) vende dhe komuniteti Goran një (1) vend, nëse numri i vendeve të fituara nga secili komunitet është më i vogël se numri i vendeve të garantuara.”

Neni 66
[Zgjedhja dhe Mandati]

“1. Kuvendi i Kosovës zgjidhet me mandat katërvjeçar, duke filluar nga dita e seancës konstituive, që mbahet brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e shpalljes zyrtare të rezultateve të zgjedhjeve.
2. Zgjedhjet e rregullta për Kuvend mbahen më së voni 30 (tridhjetë) ditë para përfundimit të mandatit, kurse në raste të shpërndarjes së Kuvendit, jo më vonë se dyzet e pesë (45) ditë pas shpërndarjes.

3. Presidenti i Republikës së Kosovës e thërret seancën e parë të Kuvendit. Në rast se Presidenti i Republikës së Kosovës nuk është në gjendje të thërrasë seancën e parë, Kuvendi mbledhet pa pjesëmarrjen e Presidentit.
4. Mandati i Kuvendit të Kosovës mund të vazhdohet vetëm në raste të Gjendjes së Jashtëzakonshme për masa emergjente të mbrojtjes ose në rast të rrezikut ndaj rendit kushtetues ose sigurisë publike të Republikës së Kosovës, dhe vetëm për atë sa zgjat Gjendja e Jashtëzakonshme, siç është përcaktuar me këtë Kushtetutë.
5. Kushtet, zonat dhe procedurat zgjedhore, rregullohen me ligj.”

Neni 67 **[Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkyetarëve]**

- “1. Kuvendi i Kosovës nga radhët e veta zgjedh Kryetarin dhe pesë (5) nënkryetarë.
2. Kryetari i Kuvendit propozohet nga grupi më i madh parlamentar dhe zgjedhet me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit.
3. Tre (3) nënkryetarët të propozuar nga tri grupet më të mëdha parlamentare, zgjidhen me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit.
4. Dy (2) nënkryetarë përfaqësojnë komunitetet që nuk janë shumicë në Kuvend dhe ata zgjidhen me shumicën e votave të të gjithë deputetëve. Njëri nënkryetar do të jetë nga radhët e deputetëve të Kuvendit që mbajnë vendet të rezervuara ose të garantuara të komunitetit Serb, dhe tjetri nënkryetar nga radhët e deputetëve të Kuvendit që mbajnë vende të rezervuara ose të garantuara nga komunitetet tjera që nuk janë shumicë.
5. Kryetari dhe nënkryetarët e Kuvendit shkarkohen me votën e shumicës prej dy të tretave (2/3) të numrit të përgjithshëm të deputetëve.
6. Kryetari dhe nënkryetarët formojnë Kryesinë e Kuvendit. Kryesia është përgjegjëse për funksionimin administrativ të Kuvendit në mënyrën e përcaktuar me Rregulloren e Punës të Kuvendit.”

Neni 74 **[Ushtrimi i Funksionit]**

“Deputetët e Kuvendit të Kosovës ushtrojnë funksionin e tyre në interesin më të mirë të Republikës së Kosovës dhe në pajtim me këtë Kushtetutë, ligjet dhe rregullat e procedurës së Kuvendit.”

Rregullore e Kuvendit të Republikës së Kosovës

Neni 7 **(Seanca konstituive)**

- “1. Seancën konstituive të Kuvendit e thërret Presidenti i Republikës së Kosovës, brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e shpalljes zyrtare të rezultatit të zgjedhjeve.
2. Në rast se Presidenti i Republikës së Kosovës nuk e thërret seancën konstituive, Kuvendi mbledhet vetë në ditën e 30 (tridhjetë).”

Neni 12 **(Zgjedhja e nënkryetarëve të Kuvendit)**

- “1. Nënkyetarët e Kuvendit zgjidhen me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit.

2. Kryetari i Kuvendit kërkon nga tri subjektet politike më të mëdha parlamentare të propozojnë nga një kandidat për nënkryetar të Kuvendit. Kandidati për nënkryetar i subjektit më të madh parlamentar duhet të jetë i gjinisë tjetër, nga ai i Kryetarit.
3. Në rast se dy ose më shumë subjekte politike kanë numër të njëjtë të deputetëve, e drejta e propozimit të nënkryetarit i takon subjektit që ka marrë më shumë vota në zgjedhjet për Kuvend.
4. Kryetari i Kuvendit kërkon nga deputetët, që mbajnë vende të garantuara për komunitetin serb që të propozojnë një (1) kandidat për nënkryetar të Kuvendit, si dhe nga deputetët, që mbajnë vende të garantuara për komunitetet e tjera, që nuk janë shumicë, të propozojnë një (1) kandidat për nënkryetar të Kuvendit, të cilët zgjidhen me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit.
5. Seanca konstituive përfundon me zgjedhjen e Kryetarit dhe nënkryetarëve të Kuvendit. Ndërprerjet gjatë seancës konstituive nuk mund të jenë më të gjata se 48 orë.
6. Propozimet nga paragrafi 4 i këtij neni bëhen me shkrim, sipas procedurës si vijon:
 - 6.1. Kandidati për nënkryetar të Kuvendit nga radhët e komunitetit serb propozohet nga shumica e deputetëve të komunitetit serb, dhe
 - 6.2. Kandidati për nënkryetar të Kuvendit nga radhët e deputetëve të komuniteteve të tjera që nuk janë shumicë propozohet nga shumica e deputetëve të komuniteteve të tjera që nuk janë shumicë.
7. Në rast të mospropozimit të kandidatëve sipas paragrafit 6 të këtij neni, propozimi i kandidatëve bëhet me short, në prani të deputetëve të komuniteteve përkatëse. Kjo procedurë administrohet nga Kryetari i Kuvendit.”

Neni 14 (Mandati i Kryetarit dhe i nënkryetarëve të Kuvendit)

“Në rastin kur Kuvendi e pezullon punën për shkak të fillimit të fushatës zgjedhore dhe në rastin kur shpërndahet, Kryetari dhe nënkryetarët vazhdojnë punën deri në seancën konstituive, me qëllim të ruajtjes së vazhdimësisë administrative të punës së Kuvendit.”

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

88. Në lidhje me vlerësimin e pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata i referohet paragrafit 1 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcakton se: *“Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar”*.
89. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës kanë parashtruar kërkesën e tyre në bazë të paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës, i cili përcakton:

“5. Dhjetë (10) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës, brenda një afati prej tetë (8) ditësh nga dita e miratimit, kanë të drejtë të kontestojnë kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi, si për përmbajtjen, ashtu edhe për procedurën e ndjekur”.
90. Përveç kriterëve të lartcekura kushtetuese, Gjykata gjithashtu merr parasysh edhe nenin 42 (Saktësimi i kërkesës) të Ligjit, që saktëson parashtrimin e kërkesës në bazë të paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës, i cili përcakton si në vijim:

Nenin 42
(Saktësimi i kërkesës)

“1. Në kërkesën e ngritur në pajtim me nenin 113, paragrafi 6 [5] të Kushtetutës, ndër të tjera, paraqiten informatat e mëposhtme:

1.1. emrat dhe nënshkrimet e të gjithë deputetëve të Kuvendit që kontestojnë kushtetutshmërinë e ligjit apo vendimit të nxjerrë nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës;

1.2. dispozitat e Kushtetutës apo të ndonjë akti apo ligji që ka të bëjë me këtë kërkesë; dhe

1.3. paraqitjen e provave mbi të cila mbështetet kontesti.”

91. Gjykata, gjithashtu, i referohet dhe rregullit 72 (Kërkesa në pajtim me paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës dhe me nenet 42 dhe 43 të Ligjit) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

Rregulli 72

(Kërkesa në pajtim me paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës dhe me nenet 42 dhe 43 të Ligjit)

“(1) Kërkesa e parashtruar sipas këtij rregulli duhet të përmbushë kriteret e përcaktuara me paragrafin (5) të nenit 113 të Kushtetutës dhe me nenet 42 (Saktësimi i kërkesës) dhe 43 (Afati) të Ligjit.

(2) [...]

(3) Kërkesa e parashtruar sipas këtij rregulli, ndër të tjera, duhet të përmbajë informatat e mëposhtme:

(a) emrat dhe nënshkrimet e të gjithë deputetëve të Kuvendit që kontestojnë kushtetutshmërinë e ligjit ose vendimit të nxjerrë nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës;

(b) dispozitat e Kushtetutës ose të ndonjë akti ose ligji që ka të bëjë me këtë kërkesë; dhe

(c) paraqitjen e provave mbi të cilat mbështetet kontesti.

(4) Kërkesës duhet t'i bashkëngjitet një kopje e ligjit ose vendimit të kontestuar të miratuar nga Kuvendi, regjistri dhe nënshkrimet personale të deputetëve që paraqesin kërkesën, si dhe autorizimi i personit që i përfaqëson ata para Gjykatës.”

92. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkesa (i) është parashtruar nga 10 (dhjetë) deputetë të Kuvendit, që është minimumi i kërkuar me paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës, dhe të cilët kanë shënuar emrat dhe nënshkrimet e tyre në kërkesën e tyre; (ii) parashtruesit e kërkesës kanë specifikuar se kontestojnë *“Procesverbalet nga seanca e Kuvendit të Kosovës”* të 10 tetorit 2025, përkatësisht procedurën për zgjedhjen nënkryetarit të Kuvendit nga komuniteti Serb, që ka rezultuar në Vendimin [nr. 09-V-071] e Kuvendit për zgjedhjen e deputetit Nenad Rašić nënkryetar i Kuvendit; (iii) të njëjtit iu janë referuar neneve specifike të Kushtetutës me të cilat ata pretendojnë se aktet e kontestuar nuk janë në përputhshmëri dhe kanë dorëzuar argumentet në mbështetje të pretendimeve të tyre; si dhe (v) parashtruesit e kërkesës kanë parashtruar kërkesën brenda afatit 8 (tetë) ditë, të përcaktuar me Kushtetutë dhe Ligj.

93. Për më tepër, duke qenë se nga parashtruesit e kërkesës kontestohen vendimet e Kuvendit përkitazi me zgjedhjen e nënkryetarit të Kuvendit, të cilat janë nxjerrë në kuadër të

zhvillimit të Seancës Konstituive të Kuvendit, të 10 tetorit 2025, Gjykata vlerëson se të njëjtat i nënshtrohen vlerësimit dhe interpretimit të Gjykatës Kushtetuese, pasi bazuar në praktikën e saj gjyqësore, edhe vetë çështja e Seancës Konstituive të Kuvendit përbën çështje kushtetuese, e cila duhet t'i nënshtrohet vlerësimit dhe interpretimit të Gjykatës (shih, rastin KO124/25, cituar më lart, paragrafët 83, 84 dhe 86).

94. Prandaj, Gjykata konstaton se parashtruesit e kërkesës kanë përmbushur kërkesat e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë e të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron që kërkesa e parashtruesve të kërkesës është e pranueshme për shqyrtim dhe në vijim, do të vazhdojë me vlerësimin e saj në merita.

Meritat e kërkesës

I. Hyrje

95. Gjykata rikujton se Seanca Konstituive e Kuvendit kishte filluar më 15 prill 2025. Më 26 gusht 2025 u zgjodhën Kryetari i Kuvendit, 3 (tre) nënkryetarët të propozuar nga 3 (tri) grupet më të mëdha parlamentare dhe nënkryetarja nga radhët e komuniteteve tjera që nuk janë shumicë. Votimi për nënkryetarin nga radhët e deputetëve të komunitetit Serb dështoi 3 (tri) herë radhazi, dhe pas refuzimit të këtij komuniteti që të propozojë një kandidat tjetër, Kryetari i zgjedhur i Kuvendit, më 28 dhe 30 gusht 2025, vazhdoi me procedurën e shortit përmes së cilës, 7 (shtatë) kandidatë dështuan të merrnin votat e nevojshme për t'u zgjedhur në këtë pozitë, ndërsa 2 (dy) deputete tjera refuzuan kandidaturën. Më 30 gusht 2025, Kryetari i zgjedhur i Kuvendit përmbylli punimet e Seancës Konstituive të Kuvendit, duke theksuar se moszgjedhja e njërit prej anëtarëve të Kryesisë së Kuvendit nuk mund ta bllokojë punën e tij. Si pasojë, 10 (dhjetë) deputetë të Kuvendit parashtruan kërkesën KO265/25 para Gjykatës, duke kontestuar procedurën e zgjedhjes së nënkryetarëve të Kuvendit nga radhët e deputetëve të komuniteteve që nuk janë shumicë. Më 30 shtator 2025, Gjykata vendosi në lidhje me pranueshmërinë dhe meritat e kërkesës KO265/25, ku konstatoi se Seanca Konstituive e Kuvendit e filluar më 15 prill 2025 nuk kishte përfunduar si rezultat i moszgjedhjes së nënkryetarit të Kuvendit nga radhët e deputetëve të komunitetit Serb, dhe urdhëroi deputetët e zgjedhur të Kuvendit që të përfundojnë Seancën Konstituive, ashtu që ta zgjedhin anëtarin e fundit të Kryesisë së Kuvendit, përkatësisht nënkryetarin nga komuniteti Serb.
96. Më 10 tetor 2025, dhe pas hyrjes në fuqi të Aktgjykimit KO265/25, vazhdoi Seanca Konstituive e Kuvendit, e cila ka filluar më 15 prill 2025, për zgjedhjen e nënkryetarit të fundit të Kuvendit, gjegjësisht nënkryetarit nga radhët e deputetëve të komunitetit Serb. Kryetari i zgjedhur i Kuvendit ftoi përfaqësuesin e shumicës së deputetëve nga radhët e deputetëve të komunitetit Serb që të propozojë me shkrim dhe verbalisht kandidatin apo kandidaten për nënkryetar/e të Kuvendit të Republikës së Kosovës, ku ky i fundit propozoi deputetin Slavko Simić. Duke qenë se votimi dështoi për 3 (tri) herë radhazi për kandidatin e propozuar, i cili nuk mori votat e nevojshme për t'u zgjedhur nënkryetar i Kuvendit, procedura e propozimit dhe votimit për nga 3 (tri) herë u përsërit edhe për 8 (tetë) prej deputetëve tjerë të propozuar nga përfaqësuesi i shumicës së deputetëve nga radhët e komunitetit Serb, votime të cilat dështuan secilën herë. Në të njëjtën ditë, Kryetari i zgjedhur i Kuvendit kërkoi nga përfaqësuesi i shumicës së deputetëve nga radhët e komunitetit Serb që të propozojë deputetin e radhës të pakandiduar deri në atë moment nga radhët e deputetëve të komunitetit Serb, respektivisht, deputetin Nenad Rašić. Megjithatë, si rezultat i refuzimit për të propozuar të njëjtin nga ana e deputetëve të

komunitetit Serb, Kryetari i zgjedhur i Kuvendit konsideroi se në këto rrethana deputetët e komunitetit Serb po “*refuzojnë*” që të propozojnë kandidatin, prandaj vazhdoi me procedurën e shortit të përcaktuar në paragrafin 7 të nenit 12 të Rregullores së Kuvendit, me ç’ rast, konstatoi se ka mbetur vetëm një kandidat pa u votuar 3 (tri) herë radhazi dhe hodhi në votim emrin e tij. Deputeti Nenad Rašić mori 71 (shtatëdhjetë e një) vota për, 9 (nëntë) kundër, dhe 24 (njëzet e katër) abstenime, prandaj Kryetari i zgjedhur i Kuvendit pasi konstatoi se u zgjodh edhe nënkryetari i fundit i Kuvendit, përkatësisht nënkryetari nga komuniteti Serb, përmbylli Seancën Konstituive të Kuvendit, që ka filluar më 15 prill 2025.

97. Lidhur me këtë, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës kontestojnë “*procesverbalet nga seanca e Kuvendit të Kosovës*”, të 10 tetorit 2025. Gjykata rikujton se më 17 tetor 2025, ka kërkuar nga parashtruesit e kërkesës që të specifikojnë vendimet që kontestojnë si dhe të dorëzojnë të njëjtat në Gjykatë, megjithatë, Gjykata nuk ka pranuar përgjigje nga parashtruesit e kërkesës. Në këtë aspekt, Gjykata bazuar në pretendimet e parashtruesve të kërkesës vlerëson se të njëjtit, në thelb, kontestojnë procedurën e zgjedhjes së nënkryetarit nga komuniteti Serb, përkatësisht, Vendimin [nr. 09-V-071] e Kuvendit të 10 tetorit 2025, për zgjedhjen e deputetit Nenad Rašić nënkryetar i Kuvendit nga radhët e komunitetit Serb, duke pretenduar se i njëjti është zgjedhur në kundërshtim me paragrafin 4 të nenit 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkryetarëve] të Kushtetutës, nënparagrafin 1 të paragrafit 6 të nenit 12 [Zgjedhja e Nënkryetarëve të Kuvendit] të Rregullores së Kuvendit, si dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës, përfshirë Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KO265/25, pasi sipas tyre Kryetari i Kuvendit vazhdoi me përzgjedhjen, respektivisht propozimin e kandidatit për nënkryetar të Kuvendit nga radhët e komunitetit Serb, “*pa propozim dhe pa mbështetjen e shumicës së deputetëve që zënë vendet e rezervuara për komunitetin serb*”, dhe se me këtë veprim ka shkelur rregullin kushtetues që shumicës së deputetëve nga radhët e komunitetit Serb, i takon e drejta e propozimit të nënkryetarit/es së Kuvendit nga ky komunitet. Ata gjithashtu pretendojnë se Vendimi [nr. 09-V-071] i Kuvendit nuk është në pajtueshmëri me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.
98. Pretendimet e parashtruesve të kërkesës kundërargumentohen nga: (i) Kryetari i zgjedhur i Kuvendit; si dhe (ii) përfaqësuesja e Grupit Parlamentar të LVV!-së. Kryetari i zgjedhur i Kuvendit, në thelb, para Gjykatës argumenton se kishte respektuar procedurën kushtetuese dhe atë të përcaktuar në Rregulloren e Kuvendit dhe Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese në rastin KO265/25 në lidhje me hapat procedurale për zgjedhjen e nënkryetarit të Kuvendit nga radhët e deputetëve të komunitetit Serb. Kjo sepse vetëm pasi që 9 (nëntë) kandidatët e propozuar nga përfaqësuesi i këtij komuniteti dhe refuzimi i tyre për të propozuar deputetin e mbetur, Nenad Rašić, kishte vazhduar me procedurën e shortit. Ndërsa, deputetët e LVV!-së, përmes përfaqësueses së tyre, konsiderojnë se: (i) zgjedhja e deputetit Nenad Rašić me gjithsej 71 (shtatëdhjetë e një) vota, “[...] *nuk përbën shkelje të të drejtës së komunitetit serb, por përkundrazi, është shprehje e zbatimit të mirëfilltë të parimit të shtetit funksional dhe të garancisë së efektivitetit kushtetues*; (ii) Kryetari i zgjedhur i Kuvendit kishte respektuar aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese kur kishte vazhduar me procedurën e shortit; (iii) pretendimi i parashtruesve të kërkesës për analogjinë e grupit më të madh parlamentar dhe të drejtës për të propozuar kandidatin për “*Kryetar të Kuvendit*” kundrejt të drejtës që komuniteti Serb në Kuvend duhet ta ketë për zgjedhjen e nënkryetarit, nuk qëndron sepse këtë nuk e parasheh Kushtetuta në paragrafin 4 të nenit 67 të saj.

99. Duke marrë për bazë pretendimet e parashtruesve të kërkesës, të cilat ndërlidhen me procedurën e zgjedhjes së nënkryetarit të Kuvendit nga radhët e deputetëve të komunitetit Serb, si dhe argumentet dhe kundërargumentet e palëve të interesuara, Gjykata konsideron se objekt i vlerësimit të kësaj kërkesë përbën çështja nëse procedura për zgjedhjen e deputetit Nenad Rašić për nënkryetar të Kuvendit nga radhët e komunitetit Serb, nëpërmjet Vendimit [nr. 09-V-071] të Kuvendit, të 10 tetorit 2025, është në kundërshtim me paragrafin 4 të nenit 67 të Kushtetutës në lidhje me nënparagrafin 1 të paragrafit 6 të dhe paragrafit 7 të nenit 12 të Rregullores së Kuvendit.
100. Prandaj, në vijim Gjykata do të përmbledh: (i) parimet e përgjithshme në lidhje me konstituimin e Kuvendit dhe zgjedhjen e nënkryetarëve të Kuvendit nga radhët e deputetëve të komuniteteve që nuk janë shumicë, të përcaktuara në Kushtetutë, praktikën gjyqësore të Gjykatës dhe Rregulloren e Kuvendit; si dhe më pas (ii) do t'i aplikojë të njëjtat në rrethanat e rastit konkret.
- (i) *Parimet e përgjithshme për konstituimin e Kuvendit përfshirë procedurën për zgjedhjen e nënkryetarëve të Kuvendit*
101. Gjykata fillimisht rikujton paragrafin 1 të nenit 3 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, përmes të cilit përcaktohet se Republika e Kosovës është: “[...] shoqëri shumetnike, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet tjera e cila qeveriset në mënyrë demokratike, me respektim të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të veta legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore” (shih rastin e Gjykatës KO265/25, cituar më lart, paragrafi 100).
102. Gjykata rithekson se në bazë të nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit] të Kushtetutës, Kosova është Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre ku Kuvendi ushtron pushtetin legjislativ, Qeveria është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve dhe politikave shtetërore ndërsa, në mënyrë specifike, përcaktohet se pushteti gjyqësor të ushtrohet nga gjykatat (shih rastin e Gjykatës [KO203/19](#), parashtrues: *Avokati i Popullit*, Aktgjykim i 30 qershorit 2020, paragrafi 86).
103. Ashtu siç është theksuar edhe përmes praktikës gjyqësore të Gjykatës, në kuptim të funksionimit efektiv të institucioneve shtetërore, Gjykata në vazhdimësi ka ritheksuar që në shërbim të ruajtjes së rendit kushtetues të Republikës së Kosovës që bazohet në parimet e demokracisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, pluralizmit dhe ndarjes së pushtetit, Kushtetuta e Republikës së Kosovës është burim i autoritetit të çdo pushteti qeverisës dhe ajo përcakton kufijtë e ushtrimit të këtij autoriteti (shih, Aktgjykimet e Gjykatës, në rastin KO124/25, cituar më lart, paragrafi 103 dhe në rastet KO193/25 dhe KO196/25, paragrafi 130).
104. Lidhur me këtë, Gjykata përmes praktikës gjyqësore ka theksuar se hapi i parë në formimin e institucioneve kushtetuese pas zgjedhjeve, sikurse është përcaktuar në Kushtetutë, përkatësisht pas shpalljes zyrtare të rezultatit të zgjedhjeve, është konstituimi i Kuvendit, i cili bazuar në paragrafin 1 të nenit 66 të Kushtetutës, duhet të përmbushet me sukses brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e shpalljes zyrtare të rezultateve të zgjedhjeve, përmes përmbushjes të të gjitha elementeve thelbësore të konstituimit, përfshirë zgjedhjen e Kryetarit/es sipas paragrafit 2 të nenit 67 dhe nënkryetarëve sipas paragrafëve 3 dhe 4 të nenit 67 të Kushtetutës (shih aktgjykimet e Gjykatës në rastet [KO124/25](#), cituar më lart, paragrafi 93; [KO193/25 dhe KO196/25](#), cituar më lart, paragrafi 97; si dhe [KO265/25](#), cituar më lart, paragrafi 104).

105. Rrjedhimisht, Gjykata kishte konstatuar në Aktgjykimin e saj në rastin KO265/25, që konstituimi i Kuvendit përfundon pasi që të përfundojë zgjedhja e të gjithë anëtarëve të Kryesisë së Kuvendit, përfshirë nënkryetarët nga radhët e deputetëve të komuniteteve që nuk janë shumicë, brenda afatit 30 (tridhjetë) ditë, të përcaktuar në Kushtetutë dhe konfirmuar në aktgjykimet e Gjykatës (shih, *mutatis mutandis*, dispozitivin e Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KO265/25).
106. Sa i përket përbërjes së Kuvendit, Gjykata i referohet nenit 64 [Struktura e Kuvendit] të Kushtetutës, i cili përcakton se Kuvendi ka 120 (njëqind e njëzet) deputetë të zgjedhur, prej të cilës përbërje, 20 (njëzet) vende janë të garantuara për deputetët që përfaqësojnë komunitetet që nuk janë shumicë në Republikën e Kosovës, gjegjësisht, 10 (dhjetë) vende të garantuara për deputetët e komunitetit Serb, dhe 10 (dhjetë) vende të garantuara për deputetët e komuniteteve të tjera.
107. Gjykata rikujton se neni 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkyetarëve] i Kushtetutës i përmban 8 paragrafë që përcaktojnë zgjedhjen e anëtarëve të Kryesisë, përkatësisht, Kryetarit dhe nënkryetarët, si dhe rolin dhe mënyrën e funksionimit të Kryesisë së Kuvendit. Më konkretisht, paragrafët 1 dhe 6 të këtij neni përcaktojnë se Kuvendi i Kosovës nga radhët e veta zgjedh Kryetarin dhe 5 (pesë) nënkryetarë, të cilët përbëjnë Kryesinë e Kuvendit, që është përgjegjëse për funksionimin administrativ të Kuvendit. Paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 67 të Kushtetutës përcaktojnë se: (i) Kryetari i Kuvendit propozohet nga grupi më i madh parlamentar; (ii) 3 (tre) nënkryetarë propozohen nga tri grupet më të mëdha parlamentare; dhe (iii) 2 (dy) nënkryetarë përfaqësojnë komunitetet që nuk janë shumicë në Kuvend, përkatësisht komunitetin Serb dhe komunitet e tjera. Kryetari dhe nënkryetarët, zgjedhen me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit.
108. Gjykata gjithashtu vëren se procedurat sa i përket propozimit dhe zgjedhjes së nënkryetarëve të Kuvendit nga komunitetet që nuk janë shumicë, janë të specifikuar më tej në Rregulloren e Kuvendit. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton që Rregullorja e Kuvendit e miratuar sipas autorizimeve dhe kërkesave të nenit 76 të Kushtetutës përbën mjet dhe mekanizëm procedural përmes së cilës bëhet zbatimi i dispozitave kushtetuese konkrete (shih, paragrafin 106 të Aktgjykimit në rastin [KO119/14](#) [parashtrues *Xhavit Haliti dhe 29 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 05-V-001, të votuar nga 83 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të 17 korrikut 2014, Aktgjykim i 21 gushtit 2024]. Në këtë kuptim, Gjykata vëren se neni 76 [Rregullorja e punës] i Kushtetutës e konsideron Rregulloren e Kuvendit, të miratuar nga 2/3 e votave të deputetëve si një akt me fuqi ligjore detyruese përmes së cilës rregullohet organizimi dhe funksionimi i Kuvendit. Për më tepër, kjo dispozitë kushtetuese obligon Kuvendin të veprojë brenda procedurave të miratuara nga vetë Kuvendi në përputhje me rendin kushtetues të Republikës së Kosovës (shih rastin e Gjykatës, KO124/25, cituar më lart, paragrafi 148 dhe KO261/24, me parashtrues *Abelard Tahiri dhe 12 (dymbëdhjetë) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së vendimeve [nr. 08-V-798] dhe [nr. 08-V-844] të 5 dhjetorit 2024 të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Aktgjykim i 12 nëntorit 2025, paragrafi 143).
109. Paragrafi 4 i nenit 12 (Zgjedhja e nënkryetarëve të Kuvendit) të Rregullores së Kuvendit përcakton se: “Kryetari i Kuvendit kërkon nga deputetët, që mbajnë vende të garantuara për komunitetin serb që të propozojnë një (1) kandidat për nënkryetar të Kuvendit, si dhe nga deputetët, që mbajnë vende të garantuara për komunitetet e tjera, që nuk janë

shumicë, të propozojnë një (1) kandidat për nënkryetar të Kuvendit, të cilët zgjidhen me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit”.

110. Ndërsa, paragrafi 6 i nenit 12 të Rregullores së Kuvendit, përcakton se: “6. *Propozimet nga paragrafi 4 i këtij neni bëhen me shkrim, sipas procedurës si vijon: 6.1. Kandidati për nënkryetar të Kuvendit nga radhët e komunitetit serb propozohet nga shumica e deputetëve të komunitetit serb, dhe 6.2. Kandidati për nënkryetar të Kuvendit nga radhët e deputetëve të komuniteteve të tjera që nuk janë shumicë propozohet nga shumica e deputetëve të komuniteteve të tjera që nuk janë shumicë.* Tutje, paragrafi 7 i këtij neni të po kësaj rregulloreje, përcakton se: “7. *Në rast të mospropozimit të kandidatëve sipas paragrafit 6 të këtij neni, propozimi i kandidatëve bëhet me short, në prani të deputetëve të komuniteteve përkatëse. Kjo procedurë administrohet nga Kryetari i Kuvendit”.*
111. Sa i përket përfaqësimit të komuniteteve që nuk janë shumicë, Gjykata ka theksuar se marrë parasysh karakterin shumetnik të shoqërisë së Republikës së Kosovës, të përcaktuar në paragrafin 1 të nenit 3 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, përmbajtjen e paragrafit 2 të nenit 64 [Struktura e Kuvendit], paragrafët 1, 4 dhe 6 të nenit 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkyetarëve] të Kushtetutës dhe në mbështetje të vlerave dhe parimeve mbi të cilat bazohet rendi kushtetues i Republikës së Kosovës, ndër të tjera, të përcaktuara në nenet 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit] dhe 7 [Vlerat] të Kushtetutës, përfaqësimi i komuniteteve që nuk janë shumicë në Kryesinë e Kuvendit realizohet përmes zgjedhjes së 2 (dy) nënkryetarëve nga radhët e deputetëve të komuniteteve që nuk janë shumicë, respektivisht, (i) komunitetit Serb; dhe (ii) komuniteteve tjera. Për më tepër, sipas Gjykatës përfaqësimi i komuniteteve që nuk janë shumicë në Kuvend nuk është diskrecional, por detyrim kushtetues, i garantuar me dispozitat e lartcekura kushtetuese. Në këtë kontekst, Gjykata gjithashtu rikujton se paragrafi 7 i nenit 58 [Përgjegjësitë e Shtetit] të Kushtetutës përcakton se: “*Republika e Kosovës siguron, në baza jodiskriminuese, që të gjitha komunitetet dhe pjesëtarët e tyre të mund të ushtrojnë të drejtat e tyre, të specifikuara me këtë Kushtetutë*” (shih, rastin KO265/25, i cituar më lart, paragrafi 103).
112. Gjykata ka theksuar se bazuar në paragrafin 4 të nenit 67 të Kushtetutës, përkitazi me zgjedhjen e 2 (dy) nënkryetarëve të Kuvendit nga radhët e deputetëve që nuk janë shumicë, kushti i parë është që: (i) i zgjedhuri për nënkryetar/e të jetë kandidati/ja nga radhët e deputetëve të Kuvendit që mbajnë vendet e garantuara të komunitetit Serb apo komuniteteve tjera; ndërsa kushti i dytë (ii) është minimumi prej 61 (gjashtëdhjetë e një) votave për këtë propozim (shih, Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KO265/25, cituar më lart, paragrafi 112).
113. Ashtu siç ka sqaruar edhe në praktikën e saj gjyqësore, Gjykata përsërit se bazuar në paragrafin 4 të nenit 67 të Kushtetutës në lidhje me paragrafët 4, 6 dhe 7 të nenit 12 të Rregullores së Kuvendit, rezulton se nënkryetarët e Kuvendit nga radha e komuniteteve që nuk janë shumicë (i) zgjedhën me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit; dhe propozimi bëhet (ii) me shkrim (iii) nga shumica e deputetëve të komunitetit Serb apo të komuniteteve tjera që nuk janë shumicë (shih, Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KO265/25, cituar më lart, paragrafi 115).
114. Në këtë kontekst, Gjykata rithekson se propozimi për nënkryetar të Kuvendit nga radhët e deputetëve të komuniteteve që nuk janë shumicë, në rastin konkret, të komunitetit Serb, duhet që të bëhet nga shumica apo numri më i madh i deputetëve nga radhët e deputetëve të komunitetit Serb (shih, Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KO265/25, cituar më lart, paragrafi 128).

115. Gjykata thekson po ashtu se bazuar: (i) në parimin e bashkëpunimit me mirëbesim; (ii) në respekt të të drejtës për propozim që iu takon shumicës së deputetëve nga komuniteti Serb/shumicës së deputetëve të komuniteteve tjera që nuk janë shumicë për të propozuar nënkryetarët, ju takon deputetëve të zgjedhur që të gjejnë mënyrën për të zgjedhur nënkryetarët e Kuvendit nga radhët e komunitetit Serb dhe komunitetet që nuk janë shumicë, në pajtim me dispozitat kushtetuese dhe Rregulloren e Kuvendit. Gjykata nënvizon se e drejta për të propozuar kandidatët për kryetar dhe nënkryetarë përfaqëson një komponentë thelbësore të ekuilibrit kushtetues midis subjekteve politike dhe, veçanërisht garancisë kushtetuese të përfaqësimit të komuniteteve që nuk janë shumicë. Gjykata rithekson se bazuar në tekstin dhe frymën e Kushtetutës, zgjedhja e Kryetarit dhe nënkryetarëve të Kuvendit, në parim, duhet të bëhet bazuar në propozimet e grupeve parlamentare/deputetëve që kanë të drejtën kushtetuese të propozojnë kandidatët për Kryetar/nënkryetarë.
116. Gjykata, në vijim, rikujton se Rregullorja e Kuvendit në paragrafin 7 të nenit 12 të saj dhe pika IV e Dispozitivit të Aktgjykimit në rastet KO193/25 dhe KO196/25, përcaktojnë 2 (dy) mekanizma deblokues: (i) procedurën e shortit vetëm në rast të mospropozimit të kandidatëve sipas procedurës së lartcekur nga ana e komuniteteve që nuk janë shumicë, në prani të deputetëve të komuniteteve përkatëse, dhe e administruar nga Kryetari i Kuvendit; dhe (ii) votimin për kandidatin/en e njëjtë mund të realizohet vetëm deri në 3 (tre) herë, i cili mekanizëm vlen edhe në rastin e zgjedhjes së nënkryetarëve të Kuvendit (shih, Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KO265/25, cituar më lart, paragrafët 116, 129 dhe 130).
117. Megjithatë, mosvotimi i shumicës së deputetëve të zgjedhur të Kuvendit, për kandidatët e propozuar, qoftë: (i) të propozuar drejtpërdrejt nga radhët e deputetëve të komuniteteve që nuk janë shumicë, respektivisht komunitetit Serb; ose (ii) përmes procedurës së shortit, kriteri për votimin 3 (tri) herë për të njëjtin kandidat, i përcaktuar si mekanizëm deblokues në pikën IV të Aktgjykimit të Gjykatës në rastet KO193/25 dhe KO196/25, në vetvete nuk mund të bëhet pengesë për konstituimin e Kuvendit (shih Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KO265/25, cituar më lart, paragrafi 153).
118. Në vijim të kësaj, Gjykata thekson se mekanizmat e lartcekur të deblokimit, duhet të vijnë në shprehje vetëm në rrethana përjashtimore, dhe për qëllimin për të cilin ato janë përcaktuar, përkatësisht për të deblokuar konstituimin e Kuvendit, duke pasur parasysh edhe afatet kohore të përcaktuara në Kushtetutë, në mënyrë që organi legjislativ të bëhet funksional brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh, sikurse përcaktohet me paragrafin 1 të nenit 66 të Kushtetutës. Në vlerësimin e Gjykatës, zbatimi i këtyre mekanizmave në një mënyrë që do të çonte në rrethana ku shumica e deputetëve të Kuvendit përcakton se kush do të jetë përfaqësuesi i një komuniteti që nuk është shumicë pa propozimin e këtyre të fundit, në thelb, do të përbënte anashkalim të garancive formale të përcaktuara në Rregulloren e Kuvendit.
119. Po ashtu, përderisa i takon Kuvendit për të vlerësuar rrethanat që e bëjnë të domosdoshme aktivizimin e mekanizmave deblokues, Gjykata thekson fuqishëm që këto mekanizma nuk mund të përdoren si procedurë e rregullt e zgjedhjes së Kryetarit/nënkryetarëve, por vetëm në rrethana të caktuara, kur një gjë e tillë është e domosdoshme për të deblokuar procesin e konstituimit të Kuvendit dhe vetëm në masën që një gjë e tillë i shërben qëllimit kushtetues për çka këto mekanizma janë përcaktuar. Në parim, ashtu siç është theksuar më herët, propozimet nga grupet parlamentare apo deputetët që gëzojnë të drejtën e propozimit, në frymën e mirëbesimit dhe bashkëpunimit, duhet të synojnë arritjen e

konsensusit, të sigurojnë votat e nevojshme dhe të rezultojnë në zgjedhjen e kandidatëve ashtu siç janë propozuar dhe siç parashihet me Kushtetutë. Për më tepër, duke u mbështetur në përcaktimet kushtetuese të lartcekura, ky parim ka rëndësi të veçantë për garantimin e së drejtës së përfaqësimit të komuniteteve që nuk janë shumicë, të cilat nuk disponojnë numrin e nevojshëm të votave për të siguruar vetë zgjedhjen e përfaqësuesve të tyre në kryesinë e Kuvendit.

120. Gjykata thekson se, si standard kushtetues për zgjedhjen e nënkryetarëve të Kuvendit nga radhët e komuniteteve që nuk janë shumicë, e drejta e propozimit, përderisa e njëjta ushtrohet në pajtim me kërkesat formale dhe në mirëbesim nga këta të fundit ashtu siç është e përcaktuar në Rregulloren e Kuvendit dhe në frymën e Kushtetutës, u takon shumicës së deputetëve të zgjedhur nga radhët e komuniteteve që nuk janë shumicë sipas nënparagrafëve 1 dhe 2 të paragrafit 2 të nenit 64 [Struktura e Kuvendit] të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 6 të nenit 12 të Rregullores së Kuvendit, ngase të njëjtit gëzojnë legjitimitetin më të lartë demokratik brenda komuniteteve përkatëse.

(ii) Aplikimi i parimeve në rrethanat e rastit konkret

121. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës, në thelb, kontestojnë procedurën e zgjedhjes së nënkryetarit nga radhët e deputetëve të komunitetit Serb të Kuvendit të Republikës së Kosovës, përkatësisht, Vendimin [nr. 09-V-071] e Kuvendit të 10 tetorit 2025, për zgjedhjen e deputetit Nenad Rašić nënkryetar të Kuvendit, duke pretenduar se i njëjti nuk përfaqëson komunitetin Serb, ndër të tjera, pasi që ai nuk është propozuar nga shumica e deputetëve të komunitetit në fjalë.
122. Në lidhje me këtë Gjykata rikujton se sipas parimeve të lartcekura, që burojnë nga Kushtetuta dhe Rregullorja e Kuvendit, dhe të cilat janë të definuara në praktikën gjyqësore të Gjykatës, relevante në rrethanat e rastit konkret, rezultojnë se:
- (i) Kuvendi i Kosovës nga radhët e veta zgjedh Kryetarin dhe 5 (pesë) nënkryetarë, të cilët formojnë Kryesinë e Kuvendit;
 - (ii) konstituimi i Kuvendit duhet të përmbushet me sukses brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e shpalljes zyrtare të rezultateve të zgjedhjeve, përmes përmbushjes të të gjitha elementeve thelbësore të konstituimit, përfshirë zgjedhjen e Kryetarit/es dhe nënkryetarëve;
 - (iii) Kryetari/ja i/e Kuvendit propozohet nga grupi më i madh parlamentar;
 - (iv) 3 (tre) nënkryetarë propozohen nga tri grupet më të mëdha parlamentare; ndërsa 2 (dy) nënkryetarë përfaqësojnë komunitetet që nuk janë shumicë në Kuvend, përkatësisht komunitetin Serb dhe komunitet e tjera; dhe
 - (v) në mënyrë që të zgjedhen kandidatët për Kryetar/e dhe nënkryetarë kërkohen votat e shumicës së të gjithë deputetëve të Kuvendit, përkatësisht 61 (gjashtëdhjetë e një) vota.
123. Sa i përket procedurës së propozimit dhe zgjedhjes së nënkryetarëve nga komunitetet që nuk janë shumicë:
- (i) Kandidati/ja për nënkryetar/e të Kuvendit nga (a) radhët e deputetëve të komunitetit Serb propozohet nga shumica e deputetëve të komunitetit Serb; përderisa kandidati për nënkryetar të Kuvendit nga (b) radhët e deputetëve të komuniteteve të tjera që nuk janë shumicë propozohet, nga shumica e deputetëve

- të komuniteteve të tjera që nuk janë shumicë, në përputhje me kërkesat formale dhe në mirëbesim;
- (ii) votimi për kandidatin/en e njëjtë mund të realizohet vetëm deri në 3 (tre) herë, parim që vlen për kandidatët për Kryetar/e dhe për kandidatët për nënkryetarë të Kuvendit; dhe
 - (iii) në rast të mospropozimit të kandidatëve nga deputetët e komuniteteve që nuk janë shumicë, propozimi i kandidatëve bëhet me short, në prani të deputetëve të komuniteteve përkatëse, procedurë kjo e administruar nga Kryetari/ja i/e Kuvendit.
124. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata rikujton se më 26 gusht 2025, u zgjodhën Kryetari i Kuvendit, 3 (tre) nënkryetarët e propozuar nga 3 (tri) grupet më të mëdha parlamentare, dhe nënkryetarja nga radhët e komuniteteve tjera që nuk janë shumicë. Votimi për nënkryetarin e propozuar nga shumica e deputetëve nga radhët e deputetëve të komunitetit Serb dështoi 3 (tri) herë radhazi, dhe pas refuzimit të këtij komuniteti që të propozojë një kandidat tjetër, Kryetari i zgjedhur i Kuvendit, më 28 dhe 30 gusht 2025, vazhdoi me procedurën e shortit ku 7 (shtatë) kandidatë dështuan të merrnin votat e nevojshme për t'u zgjedhur në këtë pozitë ndërsa 2 (dy) deputete të tjera refuzuan kandidaturën. Si pasojë, 10 (dhjetë) deputetë të Kuvendit parashtruan kërkesën KO265/25 para Gjykatës, duke kontestuar procedurën e zgjedhjes së nënkryetarëve të Kuvendit nga radhët e deputetëve të komuniteteve që nuk janë shumicë.
125. Më 30 shtator 2025, Gjykata vendosi në lidhje me pranueshmërinë dhe meritat e kërkesës KO265/25, dhe gjeti se dy mekanizmat deblokues, respektivisht, (i) votimi 3 (tri) herë për të njëjtin kandidat dhe (ii) procedura e shortit, i kanë dhënë mundësinë Kuvendit që të votojë njërin nga kandidatët e propozuar për nënkryetar të Kuvendit nga radhët e deputetëve të komunitetit Serb, por deputetët e zgjedhur të Kuvendit kishin dështuar që të zgjedhin njërin nga nënkryetarët e Kuvendit, apo anëtarin e pestë të Kryesisë së Kuvendit pasi që asnjëri nga kandidatët nuk mori 61 (gjashtëdhjetë e një) vota për t'u zgjedhur në këtë pozitë (shih, Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KO265/25, cituar më lart, paragrafët 134). Bazuar në parimet e lartcekura, duke qenë se (i) afati prej 30 (tridhjetë) ditëve për konstituimin e Kuvendit ende nuk ishte konsumuar pasi kishin mbetur edhe 12 (dymbëdhjetë) ditë për realizimin e Seancës Konstituive; dhe se (ii) të gjithë kandidatët e propozuar drejtpërdrejtë ose përmes shortit, përkatësisht, votimi për 8 (tetë) kandidatët nga radhët e deputetëve të komunitetit Serb kishte dështuar nga 3 (tri) herë, ndërsa 2 (dy) kandidate kishin refuzuar kandidaturën, Gjykata urdhëroi deputetët e zgjedhur të Kuvendit që të konstitudojnë Kuvendin duke zgjedhur nënkryetarin nga radhët e deputetëve të komunitetit Serb, brenda afatit të mbetur prej 12 (dymbëdhjetë) ditëve, gjithnjë duke respektuar procedurën e përcaktuar me Kushtetutë dhe Rregulloren e Kuvendit. Gjykata rikujtoi gjithashtu se deputetët e zgjedhur të Kuvendit duhet të jenë të pranishëm dhe votojnë për, kundër apo të abstenojnë për zgjedhjen e nënkryetarit të komunitetit Serb, në frymën e detyrimit për bashkëpunim konstruktiv në mirëbesim, dhe duhet të ushtrojnë funksionin e tyre në interesin më të mirë të Republikës së Kosovës në pajtim me Kushtetutën, ligjet dhe rregullat e procedurës së Kuvendit (shih dispozitivin e Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KO265/25).
126. Nga shkresat e lëndës rezulton se më 10 tetor 2025, dhe pas hyrjes në fuqi të Aktgjykimit KO265/25, vazhdoi Seanca Konstituive e Kuvendit. Kryetari i zgjedhur i Kuvendit ftoi përfaqësuesin e shumicës së deputetëve nga radhët e deputetëve të komunitetit Serb që të propozojë me shkrim dhe verbalisht kandidatin apo kandidaten për nënkryetar/e të

Kuvendit të Republikës së Kosovës, ashtu siç përcaktohet me paragrafin 6 të nenit 12 të Rregullores, veprim ky që u realizua duke propozuar kandidatin Slavko Simić.

127. Gjykata vëren se votimi dështoi për 3 (tri) herë radhazi për kandidatin e parë të propozuar, i cili nuk mori 61 (gjashtëdhjetë e një) votat e nevojshme për t'u zgjedhur nënkryetar i Kuvendit. Prandaj, bazuar në gjetjet e Aktgjykimit KO193/25 dhe KO196/25, Kryetari i Kuvendit ftoi deputetët nga radhët e komunitetit Serb, që të ndërrojnë kandidatin e propozuar. Procedura e propozimit dhe votimit për nga 3 (tri) herë u përsërit edhe për 8 (tetë) kandidatë të tjerë të propozuar nga shumica e deputetëve nga radhët e komunitetit Serb, votime të cilat dështuan secilën herë.
128. Në të njëjtën ditë, Kryetari i zgjedhur i Kuvendit kërkoi nga përfaqësuesi i shumicës së deputetëve nga radhët e komunitetit Serb që të propozojnë deputetin e radhës të pakandiduar deri në atë moment nga radhët e deputetëve të komunitetit Serb, respektivisht, deputetin Nenad Rašić.
129. Nga transkripti i Seancës Konstituive, të mbajtur më 10 tetor 2025 rezultoi se shumica e deputetëve nga radhët e deputetëve të komunitetit Serb, theksuan se: *“Në përputhje me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese 265/25, pika 126, thuhet qartë: Kandidati për nënkryetar duhet të ketë mbështetjen e shumicës së deputetëve që mbajnë vendet e parapara për komunitetin Serb. Ne kemi listuar që të nëntë kandidatët që kanë një mbështetje të tillë, dhe unë personalisht solla nënshkrimet për të gjithë ata emra. Kështu që tani mund të propozojmë përsëri vetëm dikë nga radhët e popullit serb, i cili është pjesë e Listës serbe, sepse vetëm ata kandidatë kanë nëntë nënshkrime të mbështetjes në përputhje me nenin 67 të Kushtetutës, si dhe nenin 12 të Rregullores së punës së Kuvendit, në të cilën referohet në paragrafin 126 aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese 265/25. Çdo gjë tjetër do të ishte shkelje e Kushtetutës dhe do të na çonte më tej në krizë institucionale. Ju lutem, mos e shtyni diçka që është fakt dhe që është e qartë. Kjo pozitë i takon vetëm atij kandidati që ka nëntë nënshkrime të mbështetjes nga deputetët që mbajnë vendet e parapara për komunitetin Serb. Faleminderit!”*
130. Duke qenë se përfaqësuesi i shumicës së deputetëve nga radhët e komunitetit Serb kërkoi propozimin e kandidatëve nga shumica e deputetëve të komunitetit Serb, Kryetari i zgjedhur i Kuvendit konsideroi se, në këto rrethana, deputetët e komunitetit Serb *“po refuzohet[jnë] që të propozojnë kandidatin e mbetur, i cili deputet po ashtu përfaqëson komunitetin serb”*. Prandaj, i njëjti vazhdoi me procedurën e shortit të përcaktuar në paragrafin 7 të nenit 12 të Rregullores së Kuvendit, i cili teknikisht nuk u realizua meqenëse Kryetari i zgjedhur i Kuvendit konstatoi se kishte mbetur vetëm një kandidat pa u votuar 3 (tri) herë radhazi, si dhe për pasojë e hodhi në votim emrin e këtij kandidati. Deputeti Nenad Rašić mori 71 (shtatëdhjetë e një) vota për, 9 (nëntë) kundër, dhe 24 (njëzet e katër) abstenime.
131. Gjykata fillimisht vëren se, bazuar në atë që u theksua më lart, deputeti Nenad Rašić, si njëri nga deputetët që përfaqëson komunitetin Serb në Kuvendin e Republikës së Kosovës, arriti të marrë votat e shumicës së të gjithë deputetëve të Kuvendit, përkatësisht 71 (shtatëdhjetë e një) vota për, nga 120 (njëqind e njëzetë) deputetë sa ka Kuvendi i Republikës së Kosovës. Gjykata gjithashtu vëren se kundër propozimit të deputetit Nenad Rašić, votuan 9 (nëntë) deputetët që përfaqësojnë shumicën e deputetëve nga radhët e komunitetit Serb.

132. Së dyti, sa i përket procedurës së ndjekur për propozimin e kandidatit për nënkryetar të Kuvendit nga radhët e komunitetit Serb, Gjykata vëren se kandidati i parë për nënkryetar të Kuvendit nga radhët e komunitetit Serb ishte propozuar nga shumica e deputetëve të komunitetit Serb. Megjithatë, i njëjti nuk kishte arritur të marrë votat e nevojshme përkatësisht, të paktën 61 (gjashtëdhjetë e një) vota në Kuvend. I njëjti nuk kishte arritur të merrte votat e nevojshme as pas 3 (tre) rundeve të votimit.
133. Së treti, dhe bazuar në faktin që kandidati i parë i propozuar nuk kishte arritur votat e nevojshme as pas 3 (tre) rundeve të votimit, Kryetari i zgjedhur i Kuvendit ftoi përfaqësuesin e shumicës së deputetëve nga radhët e komunitetit Serb që të ndërrojë kandidatin e propozuar me një deputet tjetër. Në vijim, votimi për nga 3 (tri) herë u zhvillua edhe për 8 (tetë) prej deputetëve tjerë të propozuar nga shumica e deputetëve nga radhët e komunitetit Serb, votime të cilat dështuan, pasi asnjëri nga ta, për tri herë radhazi, nuk arriti që të merr 61 (gjashtëdhjetë e një) votat e kërkuara për t'u zgjedhur nënkryetar/e i/e Kuvendit.
134. Rrjedhimisht, Gjykata vëren se asnjëri nga 9 (nëntë) deputetët e propozuar nga shumica e deputetëve nga radhët e komunitetit Serb në Kuvend nuk kishte arritur që të merr votat e nevojshme për t'u zgjedhur nënkryetar/e i/e Kuvendit.
135. Si pasojë, Kryetari i zgjedhur i Kuvendit kishte kërkuar nga deputetët nga radhët e komunitetit Serb në Kuvend që të vazhdojnë me propozimin e radhës për nënkryetar të Kuvendit, përkatësisht me të vetmin deputet të mbetur pa iu nënshtruar votimit, që përfaqëson komunitetin Serb në Kuvend, z. Nenad Rašić.
136. Gjykata thekson se (i) as Kushtetuta e as Rregullorja e Kuvendit nuk bën dallimin në mes të deputetëve që përfaqësojnë komunitetin Serb në Kuvend, qoftë me përkatësinë tyre partiake apo ideologjike apo bazë tjetër, por i përfshin ata në grupin e deputetëve që përfaqësojnë komunitetin Serb, sipas deklarimeve të tyre paraprake për vendet e garantuara në Kuvend për komunitetin në fjalë; dhe se (ii) votimi për kandidatin/en e njëjtë mund të realizohet vetëm deri në 3 (tre) herë, me përjashtim të rasteve kur konsumohen të gjithë kandidatët e propozuar nga komuniteti në fjalë, dhe në këtë rast procedura e zgjedhjes së nënkryetarëve, përjashtimisht, mund të përsëritet, nëse afati për konstituimin e Kuvendit nuk ka përfunduar dhe të ketë vullnet të deputetëve të zgjedhur të Kuvendit për ta konstituuar Kuvendin (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KO265/25, cituar më lart).
137. Në rastin konkret, të gjithë kandidatët e propozuar nga shumica e deputetëve nga radhët e komunitetit Serb, gjithsej 9 (nëntë) kandidatë ishin votuar nga 3 (tri) herë, pas propozimit nga ana e përfaqësuesit të tyre. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se shumica e deputetëve nga radhët e komunitetit Serb ka shfrytëzuar të drejtën e propozimit për nënkryetar të Kuvendit, respektivisht, anëtar të Kryesisë së Kuvendit, si dhe pas kërkesës nga Kryetari i zgjedhur i Kuvendit që të propozohet deputeti i mbetur i pa votuar nga radhët e komunitetit Serb, përfaqësuesi i shumicës së deputetëve në radhët e komunitetit Serb kërkoi ripropozimin e kandidatëve nga kjo shumicë bazuar në të drejtën e përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 67 të Kushtetutës në lidhje me nënparagrafin 1 të paragrafit 6 të nenit 12 të Rregullores së Kuvendit.
138. Gjykata rikujton se për të aktivizuar mekanizmin deblokues të shortit, të përcaktuar në paragrafin 7 të nenit 12 të Rregullores së Kuvendit, duhet të vijnë në shprehje rrethana

përrjashtimore, me ç' rast shumica e deputetëve nga radhët e komuniteteve që nuk janë shumicë nuk do të propozonte kandidatët sipas paragrafit 6 të këtij neni.

139. Për pasojë, Gjykata vlerëson se zgjedhja e deputetit z. Nenad Rašić në pozitën e nënkryetarit të Kuvendit (i) nuk ka ardhur si propozim nga shumica e deputetëve nga radhët e komunitetit Serb, si dhe (ii) nuk ka pasur refuzim për të shfrytëzuar këtë të drejtë nga ana e shumicës së deputetëve nga radha e komunitetit Serb.
140. Marrë parasysh rrethanat e lartcekura, Gjykata nuk mund të konstatojë se në rrethanat e rastit konkret, mekanizmi deblokues sipas paragrafit 7 të nenit 12 të Rregullores së Kuvendit, respektivisht, procedura e shortit është përdorur në pajtim me frymën dhe qëllimin për të cilën e njëjta është paraparë. Kjo për arsye se zbatimi i këtij mekanizmi në një mënyrë që do të çonte në rrethana ku shumica e deputetëve të Kuvendit përcakton se kush do të jetë përfaqësuesi i një komuniteti që nuk është shumicë pa propozimin e këtyre të fundit, në thelb, do të përbënte anashkalim të garancive kushtetuese dhe atyre të përcaktuara në Rregulloren e Kuvendit.
141. Për më tepër, Gjykata rikujton rrethanat faktike në Aktgjykimin e saj në rastin KO265/25, me ç' rast, shumica e deputetëve nga radhët e komunitetit Serb kishin refuzuar propozimin e kandidatëve tjerë përveç kandidimit të deputetit Slavko Simić, procedura e votimit për të cilin kishte dështuar gjithsej 3 (tri) herë, si dhe faktin se të njëjtit nuk kishin marrë pjesë në votim gjatë procedurës së shortit të zhvilluar nga Kryetari i zgjedhur i Kuvendit (shih, rastin KO265/25, cituar më lart, paragrafi 148). Për dallim nga kjo, në rrethanat e rastit konkret, përfaqësuesi i shumicës nga radhët e deputetëve të komunitetit Serb, ashtu siç është theksuar edhe më lart, kishte propozuar me shkrim dhe verbalisht 9 (nëntë) kandidatët nga radha e deputetëve të kësaj shumice sipas procedurës së përcaktuar në nënparagrafin 1 të paragrafit 6 të nenit 12 të Rregullores së Kuvendit, si dhe të njëjtit morën pjesë në votimet e zhvilluara më 10 tetor 2025, përfshirë votimin kundër deputetit Nenad Rašić, për çka edhe Gjykata ka ardhur në konkluzionin se nuk janë plotësuar kushtet për aktivizimin e mekanizmit deblokues të procedurës së shortit, të përcaktuar në paragrafin 7 të nenit 12 të Rregullores së Kuvendit.
142. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se procedura për zgjedhjen e nënkryetarit nga komuniteti Serb, përkatësisht, Vendimi [nr. 09-V-071] i Kuvendit, i 10 tetorit 2025, për zgjedhjen e deputetit Nenad Rašić nënkryetar të Kuvendit nga radhët e deputetëve të komunitetit Serb, nuk është në përputhshmëri me paragrafin 4 të nenit 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkryetarëve] të Kushtetutës në lidhje me nënparagrafin 1 të paragrafit 6 të dhe paragrafit 7 të nenit 12 (Zgjedhja e nënkryetarëve të Kuvendit) të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës.
143. Gjykata thekson se një vlerësim i tillë bazohet mbi parimet e përcaktuara në Kushtetutë, praktikën e saj gjyqësore dhe Rregulloren e Kuvendit, sipas së cilave, ndër të tjera, rezultojnë se: (i) njëri nga 2 (dy) nënkryetarët që përfaqësojnë komunitetet që nuk janë shumicë në Kuvend, është nga deputetët që përfaqësojnë komunitetin Serb; (ii) propozimi bëhet (a) me shkrim (b) nga shumica e deputetëve të komunitetit Serb apo të komuniteteve tjera që nuk janë shumicë; (iii) në anën tjetër, i njëjti zgjedhet me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit, ngase shmangia nga ky standard kushtetues cenon legjitimitetin kushtetues të procesit të konstituimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Në rrethana specifike, ekziston mekanizmi deblokues i procedurës së shortit që mund të përdoret në rast të mospropozimit të kandidatëve sipas procedurës së lartcekur nga ana e shumicës së

deputetëve nga radhët e komuniteteve që nuk janë shumicë, i zhvilluar në prani të tyre, dhe i administruar nga Kryetari i Kuvendit.

144. Gjykata rithekson se bazuar (i) në parimin e bashkëpunimit me mirëbesim; (ii) në respekt të së drejtës për propozim që i takon shumicës së deputetëve nga komuniteti Serb/shumicës së deputetëve të komuniteteve tjera që nuk janë shumicë për të propozuar nënkryetarët, u takon deputetëve që të gjejnë mënyrën për të zgjedhur Kryetarin dhe nënkryetarët të Kuvendit, në pajtim me dispozitat kushtetuese dhe Rregulloren e Kuvendit, dhe të bëjnë Kuvendin funksional. Dhe kjo, në parim, bëhet bazuar në propozimet e shumicës së deputetëve që propozojnë kandidatët për nënkryetarë nga radhët e komuniteteve që nuk janë shumicë. Përkatësisht, e drejta e shumicës për propozimin e kandidatit për nënkryetar nga komunitetet që nuk janë shumicë, e përcaktuar dhe e garantuar me Kushtetutë, duhet të respektohet nga të gjithë deputetët dhe të realizohet përmes bashkëpunimit në mirëbesim, ku deputetët, në ushtrimin e funksioneve të tyre, veprojnë në interesin më të mirë të shtetit. Për më tepër, Gjykata rithekson se kjo ka rëndësi të veçantë për përfaqësimin e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kuvend dhe në Kryesinë e Kuvendit, të cilat nuk kanë numrin e nevojshëm të votave për të zgjedhur, pa mbështetjen e deputetëve të tjerë, anëtarët e Kryesisë së Kuvendit.
145. Gjykata rithekson rëndësinë thelbësore të respektimit të aspektit procedural në procesin e konstituimit të Kuvendit, i cili është përcaktuar me Kushtetutë dhe i saktësuar më tej me Rregulloren e Kuvendit, përfshirë edhe aspektin përmbajtësor për të drejtën e përfaqësimit të komuniteteve që nuk janë shumicë. Të dyja këto duhet të zbatohen dhe jetësohen në përputhje me dispozitat dhe garancitë kushtetuese, duke i dhënë kuptim vlerave kushtetuese të qeverisjes demokratike të institucioneve të Republikës së Kosovës dhe respektimit të parimit të barazisë para ligjit, përmes përfaqësimit dhe pjesëmarrjes së komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në institucionet e Republikës së Kosovës. Në këtë drejtim dhe në kuptim të kërkesave të paragrafit 7 të nenit 58 [Përgjegjësitë e Shtetit] të Kushtetutës, Gjykata rithekson se është përgjegjësi e shumicës që të sigurojë përfaqësim efektiv të komuniteteve që nuk janë shumicë në institucionet shtetërore të Republikës së Kosovës, gjegjësisht në Kryesinë e Kuvendit. Njëkohësisht, Gjykata rikujton se është përgjegjësi e komuniteteve që nuk janë shumicë, që në realizimin e të drejtave kushtetuese, të sillen në përputhje me kërkesat kushtetuese dhe ligjore të Republikës së Kosovës.
146. Në këtë aspekt, Gjykata thekson se mekanizmat e deblokimit, të përcaktuara në Rregulloren e Kuvendit, dhe në praktikën gjyqësore bazuar në frymën e Kushtetutës, mund të vijnë në shprehje në rrethana përjashtimore, dhe për qëllimin për të cilin ato janë përcaktuar, përkatësisht në funksion të konstituimit të Kuvendit, duke pasur parasysh edhe afatet kohore të përcaktuara në Kushtetutë që organi legjislativ të bëhet funksional brenda 30 (tridhjetë) ditësh. Kjo sepse, në parim, propozimet nga grupet parlamentare apo deputetët që gëzojnë të drejtën e propozimit, në frymën e mirëbesimit dhe bashkëpunimit ndërmjet deputetëve, duhet të synojnë arritjen e konsensusit, të sigurojnë votat e nevojshme dhe të rezultojnë në zgjedhjen e kandidatëve ashtu siç janë propozuar dhe sikurse përcaktohet në shkronjën dhe frymën e Kushtetutës.
147. Marrë parasysh ngjarjet e zhvilluara pas parashtrimit të kësaj kërke në Gjykatë, siç janë reflektuar në paragrafët 52-57, Gjykata, duke u bazuar në parimin e sigurisë juridike, e konsideron të nevojshme që të sqarojë që, ky Aktgjykim në rrethanat e rastit konkret nuk ka efekt prapaveprues.

Lidhur me kërkesën për masë të përkohshme

148. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës po ashtu kërkojnë nga Gjykata që të vendosë masë të përkohshme sepse sipas tyre: *“[...] do të ndalohen më tej veprimet antikushtetuese të kryetarit të Kuvendit, në mënyrë që të mos zgjidhet një Qeveri antikushtetuese, sepse mosvendosja e masës së përkohshme do të shkaktoje dëm të pariparueshëm në formimin e institucioneve antikushtetuese, duke rrezikuar kështu rendin demokratik në Kosovë.”*
149. Në këtë kontekst, marrë parasysh që Gjykata tashmë ka vendosur lidhur me kërkesën e parashtruesve të kërkesës, Gjykata thekson se është i panevojshëm shqyrtimi i mëtejshëm i kërkesës për masë të përkohshme (shih, rastet e Gjykatës KO124/25, cituar më lart, paragrafët 192-193; dhe [KI207/19](#), parashtrues NISMA Socialdemokrate, Aleanca Kosova e Re dhe Partia e Drejtësisë, Aktgjykim i 10 dhjetorit 2020, paragrafi 237).

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit, dhe rregullat 46 (4) dhe 48 (1) (a) dhe 72 të Rregullores së punës, më 28 janar 2026:

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË, me 6 (gjashtë) vota për dhe 1 (një) kundër, kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË, me 5 (pesë) vota për dhe 2 (dy) kundër, që Vendimi [nr. 09-V-071] i Kuvendit të Republikës së Kosovës, i 10 tetorit 2025, për zgjedhjen e nënkryetarit të Kuvendit nga radhët e deputetëve të komunitetit Serb, nuk është në përputhshmëri me paragrafin 4 të nenit 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkryetarëve] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nënparagrafin 1 të paragrafit 6 dhe paragrafin 7 të nenit 12 (Zgjedhja e nënkryetarëve të Kuvendit) të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës;
- III. TË KONSTATOJË, me 5 (pesë) vota për dhe 2 (dy) kundër, që bazuar në parimin e sigurisë juridike, ky Aktgjykim në rrethanat e rastit konkret nuk ka efekt prapaveprues;
- IV. TË REFUZOJË, njëzëri, kërkesën për masë të përkohshme;
- V. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve;
- VI. TË PUBLIKOJË këtë Aktgjykim në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 (Vendimet) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës;
- VII. TË KONSTATOJË, që ky Aktgjykim hyn në fuqi në ditën e publikimit nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës dhe njoftimit të palëve.

Gjyqtari që përgatiti Aktgjykimin

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Bajram Ljatifi

Nexhmi Rexhepi